

RAPORT  
STUDIMOR

“**TË RINJTË  
NË SHQIPËRI**”

20  
19





Ky publikim realizohet në kuadër të bashkëpunimit midis Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, UT dhe Shoqatës Ardhmëria.

Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e Departamentit të Punës Sociale dhe Politikës Sociale, FSHS, UT dhe Shoqatës Ardhmëria.

### **Përgatitën raportin:**

Prof. Asoc. Dr. Veronika Duci  
Prof. Asoc. Dr. Rudina Rama  
Prof. Asoc. Dr. Eliona Kulluri Bimbashi  
MsC. Marsela Allmuca  
MsC. Endrit Maci  
MsC. Alma Kondi

### **Redaktimi shkencor:**

Prof. Asoc. Dr. Eliona Kulluri Bimbashi

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale dhe Shoqatës Ardhmëria. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Tiranë 2019

Autor: © Departamenti i Punës Sociale dhe Politikës Sociale, FSHS, UT dhe Shoqata Ardhmëria  
ISBN

### **Dizajn Grafik:**

Elinda Gjonomadhi

### **Adresa:**

Fakulteti i Shkencave Sociale, UT  
Blv. Gjergj Fishta, Tiranë

Web: <http://fshs-ut.edu.al/departamenti-i-politikave-dhe-punes-sociale/>

# MIRËNJOHJA

Ky studim u mundësua nga Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale me Shoqatën “Ardhmëria”. Autorët dhe koordinatorët e studimit dëshirojnë të falënderojnë të gjithë intervistuesit/et për kontributin e tyre në realizimin e mbledhjes së të dhënave për studimin. Gjithashtu, një falënderim shkon për të gjithë të rinjtë dhe të rejat pjesëmarrës/e në studim për motivimin e tyre për të kontribuar në këtë fushë.

## **Autorët**

# SHKURTESAT

<b>BE</b>	Bashkimi Europian
<b>MASR</b>	Ministria Arsimit, Sportit dhe Rinisë
<b>MSHMS</b>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
<b>FSHS</b>	Fakulteti i Shkencave Sociale
<b>DPPS</b>	Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale
<b>OKB (UN)</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave

# LISTA E TABELAVE

<b>Tabela 1.</b>	Analiza e besueshmërisë
<b>Tabela 2.</b>	Korrelacionet mes kënaqësisë nga jeta dhe kushteve të banesës, hapësirës së saj, kënaqësisë nga lagjia/komuniteti, gjendjes financiare, punësimit dhe kohës së udhëtimit deri në punë.

# LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1.	Gjinia e pjesëmarrësve
Grafiku 2.	Grupmoshat
Grafiku 3.	Përbërja familjare
Grafiku 4.	Statusi martesor
Grafiku 5.	Të ardhura mesatare mujore
Grafiku 6.	Niveli më i lartë i shkollimit përfundimtar
Grafiku 7.	Fusha e studimit
Grafiku 8.	Kurse të formimit profesional
Grafiku 9.	Statusi i punësimit
Grafiku 10.	Grup – profesionet
Grafiku 11.	Niveli i kënaqësisë
Grafiku 12.	Kushtet e banesës
Grafiku 13.	Siguria fizike
Grafiku 14.	Kënaqësia nga gjendja financiare individuale
Grafiku 15.	Kënaqësia nga jeta sipas nivelit arsimor
Grafiku 16.	Gjendja emocionale gjatë muajit të fundit
Grafiku 17.	Familja
Grafiku 18.	Kontaktet me të afërmit
Grafiku 19.	Kënaqësia nga infrastruktura në shkollë/universitet
Grafiku 20.	Kënaqësia mësimdhënia/tekstet
Grafiku 21.	Frekuentimi i kurseve të ndryshme
Grafiku 22.	Konsultimi për zgjedhjen e profesionit/karrierës
Grafiku 23.	Kënaqësia nga zgjedhjet e profesionit/karrierës
Grafiku 24.	A lidhet puna që po bëni aktualisht me fushën në të cilën keni studiuar?
Grafiku 25.	Kënaqësia në përdorimin e kohës së lirë
Grafiku 26.	Frekuentimi i aktiviteteve kulturore
Grafiku 27.	Frekuentimi i aktiviteteve sportive
Grafiku 28.	Frekuentimi i aktiviteteve artistike
Grafiku 29.	Pjesëmarrja në aktivitete vullnetare
Grafiku 30.	Koha e ekranit
Grafiku 31.	Mbështetja në situata shqetësuese
Grafiku 32.	Besimi tek institucionet
Grafiku 33.	Shkalla e emigrimit jashtë vendit
Grafiku 34.	Mendimi për largimin nga Shqipëria
Grafiku 35.	Vlera e gjërave që bëjnë të rinjtë sipas gjinisë
Grafiku 36.	Çfarë është e rëndësishme
Grafiku 37.	Shqetësime për të ardhmen

# PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Qëllimi i këtij studimi kombëtar “Të rinjtë në Shqipëri” është të paraqesë situatën e të rinjve të moshës 18-29 vjeç në Shqipëri dhe cilësinë e jetës së tyre. Përballja e të rinjve me ndryshime dhe tranzicione madhore në jetën e tyre shpesh kthehet në sfida për vetë ata, por edhe për shoqërinë në një nivel më të gjerë pasi shoqërohen me ndryshime emocionale, sociale dhe ekonomike.

Ky studim u realizua nga Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale në bashkëpunim me Shoqatën Ardhmëria përgjatë periudhës Tetor 2018 – Janar 2019 me qëllim eksplorimin e situatës së të rinjve në Shqipëri dhe cilësinë e jetës së tyre.

Pjesëmarrësit e këtij studimi ishin N = 2041 të rinj të grupmoshës 18-29 vjeç të përzgjedhur në mënyrë rastësore bazuar në popullatën e përgjithshme të grupmoshës së të rinjve (18-29 vjeç) prej 567.054 (INSTAT, 2018) të shpërndarë në 12 qarqe të vendit sipas ndarjes paraprake rurale (49.9 %) dhe urbane (50.1%). Nga ky kampionim 51.3% ishin vajza dhe 48.7 % djem.

Pyetjet kërkimore të studimit lidhen me paraqitjen e situatës socio – demografike të të rinjve, eksplorimin e kënaqësisë së të rinjve nga kushtet e banesës dhe lagjes së tyre, me perceptimin për gjendjen e tyre emocionale, me kënaqësinë nga marrëdhëniet shoqërore dhe familjare, me faktorët ndikues në zgjedhjen e karrierës dhe të arsimimit, me përdorimin e kohës së lirë, me nivelin e besimit ndaj institucioneve të ndryshme, me vlerat më të rëndësishme për ta, dëshirën për të qëndruar apo larguar nga Shqipëria dhe perspektivën e tyre për të ardhmen.



# GJETJET KRYESORE

## A. Situata socio – demografike e të rinjve

- 80% e të rinjve jetojnë me familjen e tyre, ndërsa një përqindje e ulët prej tyre jetojnë me shokë e shoqe (7.4%) ose me partnerin/en (7.5%). Mesatarisht, ata jetojnë nën të njëjtën strehë me 5 njerëz të tjerë;
- 1 në 10 pjesëmarrës kanë të ardhura familjare nga 0 deri në 18.000 lekë;
- Në përgjithësi, të ardhurat familjare të të rinjve të studimit janë ose mesatare, nga 35.001 lek deri në 87.000 lekë (31.4%) ose të ulëta nga 18.001 lekë deri në 35.000 (28.3%);
- Fushat kryesore të studimit për të rinjtë janë biznesi/administrimi dhe ligji (21.1%), arsimi (18.6%) dhe shkencë sociale, gazetari dhe informacion (12.7%). Më pak e ndjekur është fusha e shërbimeve (2.4%) dhe e arteve dhe shkencave humane (5%);
- 1 në 4 të rinj kanë përfunduar kurse të formimit profesional, si kurse për gjuhë të huaja, estetikë, parukerie, elektroauto etj;
- 31.4% e të rinjve kanë një punë të rregullt kundrejt një page, 30.1% janë studentë ose nxënës, 17% janë të papunë, ndërsa ka dhe një përqindje prej 14% që punojnë në biznesin e familjes ose janë në profesion të lirë;
- thuajse 2 në 3 të rinj të punësuar janë në një punë me kohë të plotë;
- të rinjtë janë mesatarisht (32.4%) ose shumë të kënaqur nga puna që kanë (37.9%)

## B. Kushtet e banesës dhe perceptimi i komunitetit

- të rinjtë e studimit janë mesatarisht të kënaqur nga banesa e tyre (43.9%) dhe shumë të kënaqur nga hapësira e banesës që jetojnë (42.9%);
- 28.1% e të rinjve janë të pakënaqur nga komuniteti dhe lagjia e tyre;
- 63.8% e pjesëmarrësve janë të pakënaqur nga zonat rekreative ose argëtuese që ofron lagja dhe komuniteti ku jetojnë.
- 1 në 4 të rinj pjesëmarrës ndihen pak ose shumë të pasigurtë fizikisht në lagjen e tyre
- thuajse 2 në 3 të rinj të punësuar janë në një punë me kohë të plotë;
- të rinjtë janë mesatarisht (32.4%) ose shumë të kënaqur nga puna që kanë (37.9%)

## C. Gjendja emocionale

- kënaqësi të ulët nga jeta kanë 23.9% e pjesëmarrësve ndërsa mesatare dhe të lartë 76.1%;
- shumica e të rinjve janë ndjerë të lumtur disa herë (35.2%) ose shpeshherë (44.8%) gjatë muajit të fundit;
- një përqindje e konsiderueshme e të rinjve janë ndjerë shumë nervozë në mjaft raste gjatë muajit të fundit (58.5%) dhe të rënë moralisht (38.5%)

## D. Marrëdhëniet familjare dhe shoqërore

- marrëdhëniet me të gjithë anëtarët e familjes të rinjtë i kanë shumë të mira; mesatarja e kënaqësisë është mbi 9 për nënën, motrën/at dhe vëllain/vëllezërit. Pak më e ulët rezultoi në rastin e babait, por me një ndryshim të vogël, 8.97;
- të rinjtë takohen shpesh me të afërmit (33.1%) por shumë më shpesh me miqtë e tyre (64.1%);

## E. Shkollimi dhe zgjedhja e karrierës

- mesatarisht gjysma e të rinjve ishin të pakënaqur nga aspektet infrastrukturore të shkollës ose universitetit të tyre, si mjediset fizike dhe sportive, biblioteka, kushtet e ngrohjes dhe ftohjes etj.;
- frekuentimi i kurseve të ndryshme, si kurse të shkencave ekzakte, të formimit (ndër) personal etj. është në nivele shumë të ulëta (nën 8%). Vetëm ato të gjuhëve të huaja dhe kompjuterit frekuentohen më shumë nga të rinjtë;
- prindërit janë ata që kryesisht konsultohen të rinjtë për zgjedhjen e arsimit ose të karrierës; shkolla dhe strukturat e këshillimit të karrierës brenda saj janë në nivelet më të ulëta;

## Ë. Kënaqësia në përdorimin e kohës së lirë

- vetëm 30.8 % e të rinjve raportojnë kënaqësi të lartë në kalimin e kohës së lirë;
- Frekuentimi i aktiviteteve të ndryshme gjatë kohës së lirë, si kinemaja, teatri, ekspozita ose muze (mbi 80% nuk i frekuentojnë);
- 51.3 % e tyre janë shprehur se nuk lexojnë asnjëherë libra, 23.7 % lexojnë libra më shumë se një herë në muaj dhe 13.1 % e të rinjve lexojnë me rrallë se një herë në muaj;
- përqindja më e madhe e të rinjve nuk frekuentojnë aktivitetet sportive si futboll (68.8%), basketboll (91.3 %), volejboll (87.1%), not (93 %) dhe palestër (74.4 %);
- mosfrekuentimi i kurseve artistike dhe kulturore, si piktura, mësimi i një instrumenti muzikor, kurse baleti/kërcimi ose fotografie, është mbi 90 %;
- Aktivizimi në aktivitete vullnetare duket se është në nivele shumë të ulëta tek të rinjtë shq-

iptarë, ku më shumë se 70% e të rinjve pjesëmarrës nuk marrin pjesë në asnjë lloj aktiviteti vullnetar;

- 68.9% e të rinjve janë shprehur se kalojnë me pak se tre orë në ditë duke parë televizor;
- 20.5% e të rinjve kalojnë më shumë se 3 orë në ditë në Facebook dhe 32.3% në Instagram.

## F. Aksesimi në shërbime dhe besimi tek institucionet

- njerëzit ose institucionet ku të rinjtë do të drejtoheshin për të gjetur mbështetje në situata shqetësuese janë institucionet e besimit (100%) dhe familjarët (85.6%). Në përqindje shumë të ulëta janë shërbimet e specializuara dhe profesionistët përkatës si mjekët, punonjësit socialë etj;

- institucionet në të cilat të rinjtë kanë besim më të ulët janë Bashkitë (65%), institucionet e drejtësisë (63.5%), institucionet arsimore publike dhe private (63.3% dhe 60.8% respektivisht), spitalet (61.1%).

## G. Të rinjtë dhe emigrimi

- 35.8 % e të rinjve kishin emigruar të paktën një herë nga Shqipëria dhe 64.2 % e të rinjve nuk kishin emigruar ndonjëherë;

- 74.7 % e të rinjve të përfshirë në studim e kanë menduar largimin nga Shqipëria;

- arsyet e largimit nga Shqipëria janë punësimi (50.3 %), arsimi (13.9%) dhe siguria (3.8%).

## GJ. Të rinjtë dhe vlerat

- 29.5 % e të rinjve janë vlera e gjërave me të cilat ata merren në përditshmërinë e tyre është e ulët;

- rëndësi për të rinjtë ka të jenë të shëndetshëm (93.6% e tyre), punësimi (92.1%), të jenë të lumtur (91.7%), të jenë në një marrëdhënieje të lumtur (90.6%) dhe jetesa në një mjedis të shëndetshëm (89.6%).

## H. Të rinjtë dhe e ardhmja

- të rinjtë janë jashtëzakonisht të shqetësuar për papunësinë (83%), varfërinë (81%) dhe rritjen e çmimeve (76 %) për të ardhmen e tyre;

- pjesëmarrësit shqetësohen dhe për korrupsionin (69 %), dhunën dhe krimin (65%) dhunën në familje (64%) dhe shtimin e sëmundjeve (65 %);

- të rinjtë nuk janë të informuar ose të shqetësuar për fenomene që ndodhin jashtë kontekstit shqiptar, si luftrat brenda dhe jashtë kufijve të Europës, shfaqja e partive ekstreme të krahut të majtë ose të djathtë etj.

<p><b>1</b> <b>HYRJE</b> .....12</p> <p>    Pyetjet kërkimore..... 13</p>	<p><b>3</b> <b>METODOLOGJIA E STUDIMIT</b>.....17</p> <p>    Kampionimi..... 17</p> <p>    Metoda e intervistimit dhe instrumenti kërkimor.....18</p> <p>    Analiza e të dhënave.....18</p> <p>    Besueshmëria dhe vlefshmëria e instrumentit kërkimor .....19</p>
<p><b>2</b> <b>ANALIZA E SITUATËS</b>.....14</p>	
<p><b>4</b> <b>GJETJET</b> .....21</p> <p>    Të dhëna demografike..... 22</p> <p>    Të rinjtë dhe punësimi.....26</p> <p>    Kushtet e banesës dhe perceptimi për komunitetin.....28</p> <p>    Gjendja emocionale .....31</p> <p>    Marrëdhëniet familjare dhe shoqërore.....34</p> <p>    Shkollimi dhe zgjedhja e karrierës.....35</p> <p>    Frekuentimi i kurseve të ndryshme.....37</p> <p>    Zgjedhja e karrierës dhe profesionit.....37</p>	<p>    Kënaqësia në përdorimin e kohës së lirë..... 40</p> <p>    Të rinjtë dhe aktivitetet kulturore.....41</p> <p>    Të rinjtë dhe aktivitetet sportive.....41</p> <p>    Të rinjtë, arti dhe kultura .....42</p> <p>    Të rinjtë dhe aktivitetet vullnetare.....43</p> <p>    Të rinjtë, koha e lirë, media dhe rrjetet sociale.....43</p> <p>    Aksesi në shërbime dhe besimi tek institucionet .....44</p> <p>    Të rinjtë dhe besimi tek institucionet.....45</p>

# .. TABELA E PËRMBAJTJES

Të rinjtë dhe emigrimi .....	47
Të rinjtë dhe vlerat .....	48
Të rinjtë dhe e ardhmja.....	50

5 KONKLuzionET.....	52
---------------------	----

6 REKOMANDIMET.....	58
---------------------	----

7 REFERENCAT.....	60
-------------------	----

8 SHTOJCAT.....	62
-----------------	----

# 1. HYRJJE

Qëllimi i studimit kombëtar “Të rinjtë në Shqipëri” është të paraqesë situatën e të rinjve të moshës 18-29 vjeç në Shqipëri dhe cilësinë e jetës së tyre. Kjo periudhë e jetës së individit shënon një fazë me ngjarje të rëndësishme jetësore si zgjedhja e karrierës, ndjekja e studimeve, kalimi në tregun e punës, krijimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve të rëndësishme si martesë, familja, por edhe vendime të tjera të rëndësishme siç është zgjedhja e vendit për të jetuar dhe emigrimi. Përballja me këto ndryshime të rëndësishme në jetën e të rinjve shpesh kthehen në sfida për vetë ata, por edhe për shoqërinë në një nivel më të gjerë pasi shoqërohen me ndryshime emocionale, sociale dhe ekonomike.

Ky studim u realizua nga Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale me Shoqatën “Ardhmëria” përgjatë periudhës Nëntor 2018 – Janar 2019 me qëllim eksplorimin e situatës së të rinjve në Shqipëri dhe cilësinë e jetës së tyre.

Pjesëmarrësit e këtij studimi ishin N = 2041 të rinj të grupmoshës 18-29 vjeç të përzgjedhur në mënyrë rastësore bazuar në popullatën e përgjithshme të grupmoshës së të rinjve (18-29 vjeç) prej 567.054 (INSTAT, 2018)<sup>1</sup> të shpërndarë në 12 qarqe të vendit sipas ndarjes paraprake rurale (49.9 %) dhe urbane (50.1%). Nga ky kampionim 51.3% ishin vajza dhe 48.7 % djem.

Studimi ndihmon për të patur një tablo më të qartë të cilësisë së jetës së të rinjve në Shqipëri duke analizuar fusha të rëndësishme të jetës, të tilla si marrëdhëniet me familjarët dhe bashkëmoshatarët, marrëdhëniet me shkollën, edukimi në familje, edukimi dhe arsimimi, zgjedhja e karrierës, punësimi, interesat shoqërore/kulturore/politike, koha e lirë, lidhja e arsimimit me tregun e punës, emigrimi, besimi tek institucionet, pjesëmarrja në shoqëri, përdorimi i teknologjisë, etj., të cilat ofrojnë një bazë të mirë të dhënash për krijimin e programeve të zhvillimit për të rinjtë apo përmirësimin e atyre ekzistuese.

Raporti studimor përbëhet nga 6 kapituj kryesorë në të cilat janë analizuar në mënyrë të detajuar çështjet e synuara. Më specifikisht, në kapitullin e parë ofrohet panorama e studimit, në kapitullin e dytë paraqitet situata aktuale e të rinjve bazuar në politikat kombëtare dhe programet mbështetëse për ta; në kapitullin e tretë prezantohet në mënyrë të detajuar metodologjia e studimit, kampionimi dhe metodat e përdorura; kapitulli i katërt ofron analizën e të dhënave sipas kategorive dhe fushave të përcaktuara; kapitulli i pestë paraqet në mënyrë të përmbledhur konkluzionet e studimit sipas fushave dhe në kapitullin gjashtë jepen rekomandimet për institucionet përgjegjëse dhe hartuesit e programeve/politikave për përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve në Shqipëri.

<sup>1</sup> INSTAT, Popullsia 1 Janar 2018

## Pyetjet kërkimore

Pyetjet kërkimore të këtij studimi rrjedhin nga qëllimi i tij. Ato janë si më poshtë:

Cila është situata socio – demografike e të rinjve – pjesëmarrës të studimit?

Si është kënaqësia e të rinjve nga kushtet e banesës dhe mundësitë e ofruara nga komuniteti që jetojnë?

Si është gjendja psiko – emocionale e të rinjve?

Si i perceptojnë të rinjtë marrëdhëniet shoqërore dhe familjare?

Cilët janë faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e profesionit dhe të karrierës?

Si e përdorin të rinjtë kohën e lirë?

Si varion shkalla e besimit të të rinjve tek institucionet?

Cili është raporti i të rinjve me qëndrimin ose largimin nga vendi?

Cilat janë vlerat më të rëndësishme për të rinjtë?

Çfarë i shqetëson të rinjtë për të ardhmen e tyre?

## 2. ANALIZA E SITUATËS

Shqipëria është një nga vendet e Evropës që vazhdon të ketë një popullsi relativisht të re. Censusi i fundit, i vitit 2011, ka regjistruar 705 mijë banorë të moshës 15 – 29 vjeç ose 25% e popullsisë me një prirje për rënie në vitet në vazhdim<sup>2</sup>. Duket se shkalla e ulët e lindshmërisë dhe emigracioni ka ndikuar dhe tek numri i të rinjve në Shqipëri.

Por kush konsiderohet “i ri/e re” në Shqipëri? Në fakt, mungon një përkufizim ligjor i termit “i ri”, por ka një konsensus ndërmjet institucioneve dhe organizatave se të rinjtë i përkasin moshës 15 deri në 29 vjeç<sup>3</sup>, duke iu referuar kështu moshës së përdorur nga EUROSTAT<sup>4</sup> dhe dokumenteve politikë të Bashkimit Evropian (BE). Analiza e moshës minimale dhe maksimale për të përkufizuar rininë tregon se këto intervale janë shumë të variueshme: p.sh. në Luksemburg të rinj konsiderohen të gjithë njerëzit nga moshë 0 deri në 30 vjeç, ndërsa në Irlandë vetëm ata të moshës 15 – 24 vjeç. Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) përkufizon të rinjtë si njerëzit e moshës 15 deri në 24 vjeç<sup>5</sup>, por pa paragjykuar përkufizimet e dhëna nga shtetet përkatëse. OKB – ja shpjegon se ky përkufizim përdoret më së shumti për qëllime statistikore dhe për treguesit e saj të demografisë, arsimit, punësimit dhe shëndetit.<sup>6</sup>

Rinia është përshkruar shpesh si “kalimi nga fëmijëria, ku njeriu varet nga të tjerët tek moshë e rritur dhe pavarësia”; të rinjtë janë në tranzicion mes botës së zhvillimit të sigurt të fëmijërisë në atë të zgjedhjes së lirë dhe riskut (EUROSTAT, 2009: 17)<sup>7</sup>. Të rinjtë janë në një moment të jetës së tyre ku ata nuk kanë të drejtë më të kenë përfitimet e fëmijërisë dhe mbrojtjen përkatëse, por akoma kanë nevojë për kujdes. Të rinjtë nuk gëzojnë të gjitha mundësitë që kanë të rriturit. Është e pranuar se nuk ka një përkufizim të qartë për atë se kush konsiderohet një i ri/e re, pasi rinia përmban një sërë komponentësh socialë, ekonomikë, kulturorë dhe arsimorë, por edhe interesa, sfida dhe nevoja<sup>8</sup>.

<sup>2</sup> INSTAT (2015). Të rinjtë në Shqipëri. Marrë nga <http://www.instat.gov.al/media/2791/libri-t%C3%AB-rinjt%C3%AB-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-sfidat-n%C3%AB-koh%C3%ABt-q%C3%AB-ndryshojn%C3%AB.pdf> e aksesuar në Mars 2019

<sup>3</sup> ibid

<sup>4</sup> EUROSTAT (2015). Being young in Europe today. Marrë nga <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3217494/6776245/KS-05-14-031-EN-N.pdf/18bee6f0-c181-457d-ba82-d77b314456b9> e aksesuar në Mars 2019

<sup>5</sup> Perovic, B. (2017). Defining youth in contemporary national legal and policy frameworks across Europe. Marrë nga <https://pjp-eu.coe.int/documents/1017981/1668203/Analytical+paper+Youth+Age+Bojana+Perovic+4.4.16.pdf/eb59c5e2-45d8-4e70-b672-f8de0a5ca08c> e aksesuar në Mars 2019

<sup>6</sup> UNESCO (2014). UNESCO operational strategy on youth 2014-2021 E marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000227150>, e aksesuar në Mars 2019

<sup>7</sup> EUROSTAT (2009), Youth in Europe, A Statistical Portrait, Publications Office of the European Union, Luxembourg

<sup>8</sup> Perovic, B. (2017). Defining youth in contemporary national legal and policy frameworks across Europe. Marrë nga <https://pjp-eu.coe.int/documents/1017981/1668203/Analytical+paper+Youth+Age+Bojana+Perovic+4.4.16.pdf/eb59c5e2-45d8-4e70-b672-f8de0a5ca08c> e aksesuar në Mars 2019



Në përpjekjen e tyre për t’u bërë të rritur të pavarur të rinjtë përballen me një sërë sfidash. Statistikat tregojnë se në Shqipëri 15% e të rinjve përballen me rrezikun e varfërisë, 46% e të burgosurve janë të rinj dhe 12.7% e personave analfabetë janë të rinj. Arsimiti i të rinjve ka patur ndryshime pozitive gjatë viteve të fundit, si në rastin e uljes së diferencës ndërmjet atyre që ndjekin shkollën e mesme dhe që më pas vijojnë në arsimin e lartë. Nga ana tjetër, ka një ulje të përgjithshme të regjistrimit të të rinjve në arsimin e mesëm dhe të lartë, por studiuuesit e shpjegojnë këtë fenomen si pasojë e uljes së shkallës së lindshmërisë<sup>9</sup>.

Papunësia ose nëpunësimi vazhdojnë të mbeten një nga problemet kryesore të të rinjve. Në vitin 2015 Organizata Ndërkombëtare e Punës ka shprehur shqetësimin e saj në lidhje me papunësinë në nivele shumë të larta të të rinjve në atë kohë<sup>10</sup>. Gjatë viteve të fundit vihet re një ulje e papunësisë tek të rinjtë dhe rritje e normës së punësimin të tyre<sup>11</sup>. Papunësia dhe papunësia afatgjatë tek të rinjtë sjell një sërë pasojash të tjera, si rrezikun për varfërinë, rritjen e dëshirës për emigrim, probleme të shëndetit fizik dhe shëndetit mendor, kriminalitet më të lartë etj.

Të rinjtë që dëshirojnë të emigrojnë janë në rritje. Sipas një studimi të fundit, dëshira për të emigruar është në nivele 60 – 70 % tek të rinjtë e moshës 18-19 vjeçare dhe kulmon në moshat 28 – 30 vjeç duke arritur shifrën 81%. Këta të rinj kanë plane për të emigruar brenda një ose tre viteve<sup>12</sup>. Gjithashtu, është vënë re se dëshira për të emigruar tashmë është zhvendosur tek të rinjtë që kanë përfunduar shkollën e mesme, atë profesionale ose të lartë në ndryshim me situatën e disa viteve më përpara. Studentët janë ata që shprehin më shumë dëshirën për t’u larguar nga Shqipëria, në nivele edhe më të larta nga njerëzit e papunë dhe arsyeja kryesore për këtë tendencë është dëshira për të përmirësuar standardet e jetesës<sup>13</sup>.

Në jetën e të rinjve të rëndësishme janë dhe marrëdhëniet me shoqërinë dhe familjen, koha e lirë, aktivitetet e ndryshme, besimi dhe vlerat etj. Në studimin e fundit të Çela dhe Kamberi (2018)<sup>14</sup> mbi rininë shqiptare është konkluduar se të rinjtë kalojnë kohën e tyre të lirë duke luajtur videolojëra ose me shoqërinë apo duke lexuar libra (kjo e fundit më shumë për vajzat); shumë shpesh ata dëgjojnë muzikë. Ata kalojnë shumë kohë online (3.9 orë në ditë) dhe duke parë televizor (2.3 orë në ditë). Në po të njëjtin studim, aktivitetet sportive ishin më të pranishme tek djemtë, ndërsa aktivitetet rekreative përgjithësisht ishin në nivele të ulëta<sup>15</sup>.

Gjithashtu, autorët shprehen se të rinjtë shqiptarë janë optimistë për të ardhmen e tyre, por jo aq shumë për shoqërinë shqiptare. Ata kishin frikë nga varfëria, papunësia dhe nga korrupsioni. Familja paraqitet ende shumë ndikuese për të rinjtë, ata kanë besim tek familjet e tyre, por jo tek personat e tjerë. Në lidhje me besimet fetare, 15 % e të rinjve ndjekin rregullisht ritet fetare, por 62% u shprehën se Zoti ka një vend të rëndësishëm në jetën e tyre<sup>16</sup>.

<sup>9</sup> INSTAT (2015). Të rinjtë në Shqipëri. Marrë nga <http://www.instat.gov.al/media/2791/libri-t%C3%AB-rinjt%C3%AB-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-sfidat-n%C3%AB-koh%C3%ABt-q%C3%AB-ndryshojn%C3%AB.pdf> e aksesuar në Mars 2019

<sup>10</sup> Çela, A. dhe Kamberi, G. (2018). Rinia shqiptare 2018/19. FES Tirana. E marrë nga <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf> e aksesuar në Mars 2019.

<sup>11</sup> INSTAT (2019). Të dhëna mbi punësimin dhe papunësinë 2015 – 2018. Marrë nga <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pun%C3%ABsimi-dhe-papun%C3%ABsia/#tab2> e aksesuar në Mars 2019.

<sup>12</sup> Gëdeshi, I. dhe King., R. (2018). Tendencat e migrimit potencial nga Shqipëria. FES, Tirana. Marrë nga <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15271.pdf> e aksesuar në Mars 2019

<sup>14</sup> Çela, A. dhe Kamberi, G. (2018). Rinia shqiptare 2018/19. FES Tirana. E marrë nga <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf> e aksesuar në Mars 2019.

<sup>15</sup> ibid

<sup>16</sup> ibid

Vulnerabiliteti i moshës së rinisë ka orientuar prej vitesh politikat për adresimin e çështjeve të përmendura më sipër. Gjatë dekadave të fundit të rinjtë janë bërë pjesë e agjendave strategjike të organizmave ndërkombëtarë dhe kombëtarë. Bashkimi Evropian ka zhvilluar së fundmi Strategjinë e Rinisë së BE-së 2019 – 2027 që synon të adresojë sfidat ekzistuese dhe të ardhshme me të cilat përballen të rinjtë në Evropë. Objektivat e kësaj strategjie fokusohen në aftësimin e të rinjve për të qenë arkitektë të jetës së tyre, për të mbështetur zhvillimin e tyre dhe rritjen personale drejt autonomisë, për të ndërtuar reziliencën e tyre dhe për t'i pajisur me aftësi për jetën për t'u përballur me një botë në ndryshim. Gjithashtu, në këtë strategji theksi vihet tek ndërtimi i identitetit evropian dhe ndjenja e solidaritetit dhe aktivizmit qytetar, përmirësimi i ndikimit të të rinjve në politikë dhe zhdukja e varfërisë rinore.<sup>17</sup> Në të njëjtën linjë, Organizata e Kombeve të Bashkuara ka bërë publike së fundmi Strategjinë për Rininë 2030 me vizion: *“Një botë ku të drejtat njerëzore e çdo personi të ri janë të përmbushura; që siguron se të rinjtë janë të fuqizuar për të arritur potencialin e tyre maksimal; dhe që njeh faktin se të rinjtë janë agjentë aktivë, rezilientë dhe kanë kontribute pozitive si agjentë të ndryshimit”*.<sup>18</sup>

Në nivel kombëtar Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020 – është plani brenda Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020 që targeton nevojat specifike sociale dhe ekonomike të të rinjve. Plani i veprimit është bazuar në 6 objektiva strategjike si: nxitja e të rinjve dhe pjesëmarrja e tyre në proceset demokratike/vendimmarrje; nxitja e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës; shëndeti, sporti dhe mjedisi; edukimi i të rinjve; mbrojtja sociale; kultura dhe vullnetarizmi. Shqipëria tashmë ka edhe një ligj për rininë, të miratuar në nëntor të 2019 pas lobimit të organizatave të shoqërisë civile dhe në nenin e parë thekson se qëllimi i tij është: përcaktimin e veprimtarive, të mekanizmave dhe të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të të rinjve shqiptarë në diasporë dhe financimin e veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti, nëpërmjet: a) mbrojtjes së të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse; b) përcaktimit të funksioneve dhe të kompetencave të institucioneve qendrore e vendore publike si dhe të rolit të organizatave që ushtrojnë veprimtari për dhe në fushën e rinisë; c) krijimit të kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, për përmbushjen e potencialit të tyre në interes të shoqërisë. Aktualisht, institucioni përgjegjës në nivel qendror për çështjet e të rinjve është Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Një analizë e politikave rinore dhe buxhetimit i tyre në vitet 2015 – 2018 ka treguar një mungesë të planifikimit lokal mbi zhvillimin e politikave rinore që nuk është në përputhje me prioritetet e vendosura nga institucionet përkatëse në konsultim me aktorë të shoqërisë civile e më gjërë. Mungesa e ndarjes së buxhetit specifikisht për objektivat strategjike si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal e bën më të vështirë realizimin e tyre. Sugjerimet tregojnë se është e rëndësishme që politikat të jenë të bazuara në interesat e mirëfillta të rinisë shqiptare<sup>19</sup>.

<sup>17</sup> Official Journal of the European Union (2018). Resolution of the Council of the European Union and the Representatives of the Governments of the Member States meeting within the Council on a framework for European cooperation in the youth field. The European Union Youth Strategy 2019-2027. Marrë nga <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=OJ:C:2018:456:FULL> e aksesuar në Mars 2019.

<sup>18</sup> UN (2018). United Nations Youth Strategy. Marrë nga [https://www.un.org/youthenvoy/wp-content/uploads/2018/09/18-00080\\_UN-Youth-Strategy\\_web.pdf](https://www.un.org/youthenvoy/wp-content/uploads/2018/09/18-00080_UN-Youth-Strategy_web.pdf) e aksesuar në Mars 2019.

<sup>19</sup> Peci, D. dhe Nikolli, Xh. (2019). Vështrim mbi politikat rinore në Shqipëri: analizë në nivel vendor 2015 – 2019. Marrë nga <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/14341.pdf> e aksesuar në Shkurt 2019

# 3.

## METODOLOGJIA E STUDIMIT

Për realizimin e studimit kombëtar “Të rinjtë në Shqipëri” janë përdorur metodat sasiore të kërkimit nëpërmjet administrimit të një pyetësi i cili është shpërndarë në një kampion përfaqësues në 12 qarqe të vendit me synim eksplorimin e situatës së të rinjve si dhe cilësinë e jetës bazuar në perceptimet e tyre.

### 3.1. Kampionimi

Kampioni i studimit është përlogaritur nëpërmjet një përzgjedhjeje rastësore të bazuar në popullatën e përgjithshme të grupmoshës së të rinjve (18-29 vjeç) në Shqipëri, prej 567,054<sup>20</sup> dhe janë zhvilluar në total 2,041 pyetësorë me të rinjtë në të gjithë Shqipërinë.

Duhet të theksohet se nivelet e ndarjes sipas qarqeve, urbane-rurale, gjinisë dhe grupmoshës nuk janë nivele të publikimit, por janë vetëm nivele të kampionimit, dhe kjo është bërë për të përmirësuar efektivitetin e ndërtimit të kampionit.

Kampioni është realizuar/përzgjedhur në tre faza. Faza e parë lidhet me përzgjedhjen e Njësive Primare të Kampionimit, ku si Njësi Primare të Kampionimit, kanë shërbyer zonat gjeografike më të vogla të përcaktuara nga Qendrat e Votimit sipas zgjedhjeve më të fundit parlamentare të 2017. Brenda zonave funksionale është bërë një shtresëzim i Njësive Primare të Kampionimit sipas parametrut Urban apo Rural (Bashki/Komuna/Njësi Administrative) dhe pastaj sipas qarikut përkatës. Ky shtresëzim lejon përfaqësim sa më të mirë të kampionit. Përzgjedhja e Njësive Primare të Kampionit është realizuar duke përdorur si parameter numrin e votuesve për çdo Qendër Votimi.

Faza e dytë është përzgjedhja e familjes. Brenda njësisë primare të përzgjedhur janë përzgjedhur dyert ku trokitet për të bërë një intervistë – “Metodologjia e rrugës rastësore”. Duke ruajtur gjithmonë krahun e djathtë, intervistuesi fillon numërimin e shtëpive rezidenciale nëpërmjet një hapi të përcaktuar që ka marrë parasysh dendësinë e familjeve në zonë (p.sh. 1 në çdo 3 dyer). Dera së cilës i bie numërimi sipas hapit të përcaktuar është banesa e përzgjedhur për të kryer intervistën. Në rastet kur subjekti nuk është gjetur në banesë janë përdorur subjektet zëvendësuese të përzgjedhura paraprakisht sipas qarqeve.

Avantazhet e kampionimit me tre hapa përzgjedhjesh janë:

1. Procedura e përzgjedhjes është e thjeshtë për tu zbatuar dhe redukton mundësitë e gabimeve në procesin e përzgjedhjes.
2. Është e lehtë për të gjetur individët e përzgjedhur.
3. Kjo metodë redukton mundësitë e gabimeve në procesin e përzgjedhjes si dhe mospërgjigjet.
4. Intervistuesit intervistojnë vetëm individët në familjet e para-përzgjedhura, për të parandaluar gabimet në studim.

<sup>20</sup> INSTAT (2018), Popullsia 1 Janar 2018

Për administrimin e pyetësorit janë angazhuar një grup prej 25 intervistuesish të trajnuar paraprakisht mbi mënyrën e përzgjedhjes së kampionimit dhe administrimit të pyetësorit. Shpërndarja e anketuesve sipas qarqeve ishte 2 intervistues për secilin qark dhe norma ditore e anketuesve ishte rreth 4 pyetesorë në ditë për një muaj.

### 3.2. Metoda e intervistimit dhe instrumenti kërkimor

Në këtë studim është përdorur metoda web me anketues për mbledhjen e të dhënave nëpërmjet një pyetësori të ndërtuar në Google Form si një mënyrë shumë efektive në kohë dhe që zvogëlon ndjeshëm hedhjen dhe editimin e të dhënave pas kapjes së të dhënave. Gjithashtu të dhënat nga ky lloj anketimi ngarkohen lehtësisht në një bazë të dhënash, duke bërë të mundur analizimin e të dhënave sapo procesi i intervistimit të përfundojë, monitorimin dhe menaxhimin e të dhënave të mbledhura, si edhe ka reduktuar ndjeshëm numrin e gabimeve koduese dhe incidencën e të dhënave të munguara.

Pyetësori i përdorur për këtë studim përbëhet nga 57 pyetje të shpërndara në nëntë seksione kryesore, si: (1) Të dhënat demografike; (2) Kushtet e banesës; (3) Gjendja emocionale; (4) Marrëdhëniet familjare dhe shoqërore; (5) Shkollimi dhe zgjedhja e karrierës; (6) Koha e lirë; (7) Aksesit në shërbime dhe besimi tek institucionet; (8) Emigrimi; (9) Vlerat dhe e ardhmja.

### Të dhënat dhe cilësia e tyre

Siç u përmend më sipër në këtë studim është përdorur metoda probabilitare dhe rastësore për kampionim, e cila mundëson përgjithësimin e të dhënave dhe përdorimin e testeve statistikore parametrike. Testet e Kolmogorv – Smirnov dhe Shapiro – Wilk treguan se të dhënat nuk kanë një shpërndarje normale. Megjithatë, cilësia e vlerave të parashikuara duke u bazuar në koeficientin e variacionit është shumë e mirë (me  $N = 2041$  pjesëmarrës), pasi në të gjitha pyetjet variacioni rezulton më pak se 2 përqind. Vetëm në 3 pyetje ky koeficient është 2.1, 2.4 dhe 2.9 përqind, por sërish mbetet një tregues i mirë. (Shtojca 1. Koeficienti i variacionit)

### 3.3. Analiza e të dhënave

Të dhënat u analizuan duke përdorur paketën statistikore SPSS version 20.0 si një nga mënyrat më të mira për të analizuar të dhëna të kësaj tipologjie. Në raport janë përfshirë vetëm rezultatet statistikisht domethënëse. Për analizën e të dhënave janë përdorur statistika përshkruese, kryqëzimet e të dhënave dhe teste parametrike si ANOVA dhe korrelacionet.



### 3.4. Besueshmëria dhe vlefshmëria e instrumentit kërkimor

Besueshmëria e një pyetësoi mund të testohet duke parë konsistencën e brendshme si dhe besueshmërinë test-ritest. Zakonisht, për të matur besueshmërinë e brendshme përdoret koeficienti alpha i Cronbach-ut. Si rregull, alpha e Cronbach-ut mbi 0.70 konsiderohet si një koeficient besueshmërie i pranueshëm. Megjithatë, në raste të veçanta janë pranuar vlera mbi 0.6 ose mbi 0.5. Siç mund të shihet në tabelën 1, koeficienti alpha është në nivele të kënaqshme në të gjithë seksionet dhe nënseksionet e pyetësoit.

<b>Tabela 1. Analiza e besueshmërisë</b>	
<b>Sesioni</b>	<b>Cronbach alpha</b>
Kushtet e banimit	0.7
Gjendja emocionale	0.6
Marrëdhëniet familjare dhe shoqërore	0.8
Shkollimi dhe zgjedhja e karrierës	0.9
Frekuentimi i kurseve	0.69
Besimi tek institucionet	0.96
Vlera e aspekteve të ndryshme	0.95
Shqetësime për të ardhmen	0.96



"Të rinjtë në Shqipëri"

# TË RINJTË NË SHQIPËRI




# GJETJET


## 4.1. Të dhëna demografike

Në këtë studim kombëtar morën pjesë N = 2041 pjesëmarrës, prej të cilëve 48.7 % ishin meshkuj dhe 51.3% femra (Grafiku 1). Siç u përmend në seksionin e metodologjisë shpërndarja e pjesëmarrësve ishte e barabartë në 12 qarqe të Shqipërisë – Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë (për çdo zonë kishte mesatarisht n = 168 pjesëmarrës, me ndryshime shumë të vogla). Gjithashtu, gjysma e pjesëmarrësve vinin nga zona urbane (50.1%) dhe gjysma tjetër nga zona rurale (49.9%). Të rinjtë që kanë marrë pjesë në studim i përkisnin moshës 18 deri në 29 vjeç. Më konkretisht, 28% prej tyre ishin 18-19 vjeç, 43.8% ishin 20-24 vjeç dhe 28.2% i përkisnin grupmoshës 25 – 29 vjeç (Grafiku 2).

Grafiku 1. Gjinia e pjesëmarrësve




Grafiku 2. Grupmoshat



■ Mashkull ■ Femër ■ 18-19 Vjeç ■ 20-24 Vjeç ■ 25-29 Vjeç

Shumica e pjesëmarrësve jetonin me familjen e tyre (80%), ndërsa një përqindje e ulët prej tyre jetonin me shokë e shoqe (7.4%) ose me partnerin/en (7.5%) (Grafiku 3). Numri mesatar i anëtarëve të familjes, qoftë ajo e krijuar apo familja e origjinës ishte m = 4.7 anëtarë. Për pjesëmarrësit që nuk jetonin me familjen, numri mesatar ishte m = 0.6, diçka që tregon se të rinjtë që nuk jetojnë me familjen zakonisht ose jetojnë vetëm ose me vetëm një person tjetër. Djemtë më shumë se vajzat prireshin të jetonin vetëm (74.1% përkundrejt 25.9%).

Grafiku 3. Përbërja familjare






Në nivelin e BE – së, shifrat tregojnë se 72% e djemve të rinj dhe 60% e vajzave të reja të moshës 20–24 vjeç jetonin me prindërit e tyre në vitin 2013. Në grupin 25–29 vjeç këto përqindje ishin 43% për të rinjtë dhe 28.1% për të rejat. Tek vendet veriore të BE – së të rinjtë e lënë më shpejt shtëpinë e tyre me një moshë mesatare në fillim të të 20 – ave, ndërsa tek ato jugore moshë mesatare e largimit nga shtëpia është në fillim të të 30 – ave<sup>21</sup>. Në vitin 2017 pjesa e të rinjve të moshës 16 – 29 vjeç që jetonin me prindërit ishte 68.2 %, 73.3 % për djemtë dhe 62.9 % për vajzat<sup>22</sup>. Arsyet më të shpeshta të qëndrimit në familjen e origjinës janë të lidhura me kulturën dhe mentalitetin e një vendi, me faktin se gjatë viteve të fundit studimet universitare zgjasin më shumë se më përpara dhe koha e fillimit të punës është spostuar, por edhe moshë mesatare e martesës së parë është rritur. Përpos këtyre arsyeve, në vende si Shqipëria, por edhe në ato si SHBA, arsyet ekonomike, vështirësia për të paguar qiranë dhe papunësia kanë bërë që të ri – krijohen familje shumë – brezore.

Familjet shumë – brezore ndajnë burimet e përbashkëta si ushqimi, kujdesi për fëmijët dhe për të moshuarit, ngrohjen, elektricitetin, transportin dhe qiranë, duke reduktuar kështu koston e jetesës. Gjithashtu, mbështetja sociale e ofruar mund të reduktojë stresin dhe vetminë.<sup>23</sup> Disavantazhet e kësaj bashkëjetese janë: kufizimi i lirisë dhe autonomisë, konfliktet për shkak të brezave të ndryshëm, shëndeti fizik më i dobët dhe stres më i lartë i vazhdueshëm. Në një studim është treguar se mbështetja sociale e ofruar në një familje të tillë nuk është gjithmonë mbrojtëse e stresit dhe nuk ka gjithnjë ndikim pozitiv tek shëndeti i përgjithshëm. Kërkesat psikologjike në një familje të zgjeruar mund të shtojnë stresin tek anëtarët e saj, veçanërisht në rastet kur kjo bashkëjetese vjen si pasojë e nevojës dhe jo si zgjedhje<sup>24</sup>.

Grafiku 4. Statusi Martesor



<sup>21</sup> EUROSTAT (2015). Being young in Europe today. Marrë nga <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3217494/6776245/KS-05-14-031-EN-N.pdf/18bee6f0-c181-457d-ba82-d77b314456b9> e aksesuar në Mars 2019

<sup>22</sup> EUROSTAT (2018). Young people living with their parents. E marrë nga <https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-eurostat-news/-/DDN-20181214-1> e aksesuar në Mars 2019


<sup>23</sup> Muenning, P., Jiao, B dhe Singer, E. (2018). Living with parents or grandparents increases social capital and survival: 2014 General Social Survey-National Death Index. SSM Population Health. 4: 71–75.

<sup>24</sup> ibid

73.7% e pjesëmarrësve në këtë sondazh ishin beqarë/e dhe 20.7 % të martuar. Gjithashtu, ka patur pjesëmarrës që bashkëjetonin (4.8%), dhe në përqindje shumë të ulëta ishin ata të ndarë, të divorcuar ose të ve (Grafiku 4).

Në lidhje me të ardhurat mesatare të familjeve të të rinjve pjesëmarrës në studim vihet re se 31.4% prej tyre kanë të ardhura mujore prej 35.001 lek deri në 87.000 lekë. Një përqindje e konsiderueshme (28.3%) kanë të ardhura mujore nga 18.001 lekë deri në 35.000 lekë dhe thuhet se 1 në 10 pjesëmarrës raportojnë se të ardhurat e familjes së tyre janë nga 0 deri në 18.000 lekë (Grafiku 5). 53.8% e të rinjve të paarsimuar pohuan se kanë të ardhura më pak se 18.000 në muaj, ndërsa 37.5% e atyre me doktoraturë kanë të ardhura mbi 87.000 lekë, tregues që përforcojnë lidhjen e njohur mes të ardhurave dhe nivelit të arsimit. Situata ekonomike e familjeve të krijuara ose të origjinës së të rinjve paraqitet e vështirë, duke marrë parasysh se sipas Anketës së Buxhetit të Familjes në vitin 2017 një familje mesatare me 3.7 persona shpenzon në muaj 73.400 lekë<sup>25</sup>.

Grafiku 5 . Të ardhurat mesatare mujore



#### 4.1.1. Të rinjtë, shkollimi dhe fushat e studimit


Në lidhje me nivelin e shkollimit të pjesëmarrësve, rezultoi se pjesa më e madhe e tyre kishin përfunduar gjimnazin ose shkollën e mesme të përgjithshme (43.4%), një përqindje e konsiderueshme kishin përfunduar arsimin e lartë (25.3%) dhe disa të tjerë nivelin pasuniversitar (11.7%). Nga grafiku 6 mund të shihet se 5.7% e të rinjve ndjekin shkollën e mesme profesionale (4-5 vjeçare). Të dhënat e fundit nga të publikuara nga INSTAT tregojnë se nga një total prej 120.062 nxënës të regjistruar në vitin 2017 – 2018 në arsimin e mesëm, 20.6% ndjekin arsimin profesional<sup>26</sup>. Në shumë vende të BE-së raporti i regjistrimit në arsimin dhe formimin profesional është më i lartë, varion ndërmjet 33% deri në 84%<sup>27</sup>. Gjithashtu, vlen të theksohet se 8.4% e të rinjve kanë përfunduar vetëm arsimin e detyrueshëm.

<sup>25</sup> INSTAT (2017). Anketa e buxhetit të familjes. Marrë nga <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes/publikimet/2018/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes-2017/> e aksesuar në Mars 2019.

<sup>26</sup> INSTAT (2019). Të dhëna për arsimin. E marrë nga <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/#tab2> e aksesuar në 16 Mars 2019

<sup>27</sup> UNESCO Institute for Statistics. Të dhëna për arsimin. Marrë nga [http://data.uis.unesco.org/Index.aspx?datasetCode=EDULIT\\_DS](http://data.uis.unesco.org/Index.aspx?datasetCode=EDULIT_DS) e aksesuar në Mars 2019


Grafiku 6. Niveli më i lartë i shkollimit të përfunduar



Lidhja mes arsimit dhe punësimit është e evidentuar në shumë studime, kështu që këta të rinj mund të jenë më të prekur nga papunësia. Sipas Dumani et al. (2018) për njerëzit mbi moshën 21 vjeçare që kanë arsim të lartë niveli i varfërisë është më i lartë krahasuar me ata me arsim profesional. Gjithashtu, tek njerëzit me arsim profesional niveli i varfërisë është tre herë më i ulët në raport me ata që kanë përfunduar gjimnazin e përgjithshëm<sup>28</sup>.

Interesi i të rinjve pjesëmarrës për studimet universitare orientohet kryesisht drejt fushave si biznesi/administrimi dhe ligji (21.1%), arsimi (18.6%) dhe shkenca sociale, gazetari dhe informacion (12.7%). Më pak e ndjekur është fusha e shërbimeve (2.4%) dhe e arteve dhe shkencave humane (5%).


Grafiku 7. Fusha e studimit



<sup>28</sup> Dumani, B., Bici, R., Dumani, N., Subashi, B. dhe Kondi, A. (2018). Dissemination of Demographic and Socio-Economic Developments in Tirana with Special Attention to Youth Education. Journal of Educational and Social Research, 8 (2).

1 në 4 të rinj që kanë marrë pjesë në studim kanë përfunduar kurse të formimit profesional, si kurse për gjuhë të huaja, estetikë, parukerie, elektroauto etj (Grafiku 8). Sektori i arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri ka marrë vëmendje të veçantë gjatë viteve të fundit. Qendrat e formimit profesional ofrojnë si kurse afatshkurtra (4-6 javë), ashtu dhe afatgjata (deri në 7 muaj). Kryesisht këto kurse synojnë kualifikimin e individëve të papunë (të regjistruar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit ose jo), por kurset janë të hapura edhe për punëtorët dhe studentët, në varësi të nevojave të tyre për kualifikim<sup>29</sup>. Numri total i pjesëmarrësve në formimin profesional në vitin 2016 ishte 35.4 mijë, një numër 16% më i lartë nga viti 2014. Por, numri i pjesëmarrësve në kurse afatshkurtra (formim profesional) nuk ka rritje<sup>30</sup>. Aktualisht, pjesëmarrja e të rriturve (25 deri 64 vjeç), të cilët ndjekin kualifikimin dhe rikualifikimin profesional në qendrat publike dhe private të formimit vlerësohet të jetë 1.1%.<sup>31</sup>


Të rinjtë pjesëmarrës në kurset profesionale pranë Qendrave të Formimit Profesional Publik, përbëjnë 65% të totalit të pjesëmarrësve. Ajo që duhet theksuar është se në të gjitha profesionet pjesëmarrja e të rinjve mbetet mbi 50%. Pjesëmarrësit me nivel arsimor të mesëm përbëjnë 58.5% të totalit të pjesëmarrësve.<sup>32</sup>



#### 4.1.2. Të rinjtë dhe punësimi

Rezultatet në lidhje me punësimin e të rinjve tregojnë se 31.4% prej tyre kanë një punë të rregullt kundrejt një page, 30.1% janë studentë ose nxënës, 17% janë të papunë, ndërsa ka dhe një përqindje prej 14% që punojnë në biznesin e familjes ose janë në profesion të lirë (Grafiku 9). Nga pjesëmarrësit që kanë raportuar se punojnë (n = 1094) 64.4% ishin në një punë me kohë të plotë dhe 35.6 % me kohë të pjesshme.

Grafiku 9. Statusi i punësimit



<sup>29</sup> Ish – Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (2014). Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi dhe plani 2014 – 2020.


<sup>30</sup> UN (2018). Voluntary National Review of Sustainable Development Goals: Albania. Marrë nga [https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/20257ALBANIA\\_VNR\\_2018\\_FINAL2.pdf](https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/20257ALBANIA_VNR_2018_FINAL2.pdf) e aksesuar në Mars 2019.

<sup>31</sup> Ish – Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (2014). Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi dhe plani 2014 – 2020.

<sup>32</sup> Shërbimi Kombëtar i Punësimit (2016). Buletini statistikor 2016. E marrë nga <http://shkp.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/BULETINI-2016.pdf> e aksesuar në Mars 2019


Shumica e pjesëmarrësve ishin të punësuar në sektorin e shitjeve dhe shërbimeve (26%), si specialistë ose profesionistë (edukimi, shëndetësi, inxhinierie, ekonomie etj.) (19.3%) dhe si nëpunës (13.8%). Profesioniet më të rralla ishin ato të mbrojtjes dhe rendit (1.8%) dhe punonjësve të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve (2.7%) (Grafiku 10).

Grafiku 10. Grup profesionet



Kënaqësia e pjesëmarrësve nga puna që bëjnë është kryesisht mesatare (32.4%) dhe e lartë (37.9%). Pak më pak të kënaqur duket se janë nga koha e udhëtimit që duhet të përshkojnë nga shtëpia deri në punë ku kënaqësia mesatare shkon në 44.8% ndërsa ajo e lartë në 32.2% (Grafiku 11).

Grafiku 11. Niveli i kënaqësisë



Testi ANOVA i përdorur për të gjetur një lidhje statistikisht të rëndësishme mes gjinisë, grupmohës, punësimit dhe arsimit ka treguar se gjinia dhe arsimit ishin dy variabla me rezultate statistikisht domethënëse, ku  $p < 0.05$ . Vajzat janë më të kënaqura nga puna se sa djemtë ( $\eta^2 = 0.16$ ), me mesatare vajza = 7.54, e cila është më e lartë se mesatarja e djemve (mesatarja djem = 6.92). Sa më i lartë niveli arsimor i të rinjve aq më e lartë dhe kënaqësia nga puna, me  $\eta^2 = 0.032$ . Të rinjtë pa arsim kishin një mesatare prej 5.6 ndërsa ata me arsim të lartë e kishin 7.6.

Në të njëjtën linjë me kënaqësinë nga puna ishin dhe rezultatet e testit ANOVA për marrëdhënien mes kohës së udhëtimit deri në punë dhe gjinisë, grupmohës dhe arsimit, sipas të cilës ka një ndryshim statistikisht të rëndësishëm për të treja këto variabla, me  $p < 0.05$ . Diferenca mes djemve dhe vajzave në këtë rast nuk është shumë e madhe, për vajzat mesatarja ishte 7.2 ndërsa për djemtë 6.8 ( $\eta^2 = 0.004$ ). E njëjta prirje si në pyetjen e mësipërme ishte dhe në këtë rast përsa i përket arsimit, të rinjtë pa arsim kishin një mesatare prej 5.6 ndërsa ata me arsim të lartë prej 7.3 ( $\eta^2 = 0.012$ ). Të rinjtë e moshës 18 deri në 24 vjeç janë më pak të kënaqur nga kjo kohë ( $\eta^2 = 0.007$  dhe mesatarja = 6.75) në raport me ata të moshës 25 deri në 29 vjeç, të cilët kishin një mesatare prej 7.22.

Si përmbledhje, vajzat e reja dhe të rinjtë me arsim të lartë kanë një nivel kënaqësie më të lartë si nga puna ashtu dhe nga koha e udhëtimit deri në punë. Gjithashtu, të rinjtë e moshës më të vonë (24 – 29 vjeç) janë më të kënaqur nga koha e udhëtimit deri në punë krahasuar me ata të moshave më të vogla.


## 4.2. Kushtet e banesës dhe perceptimi për komunitetin

Në këtë seksion është eksploruar kënaqësia e pjesëmarrësve me banesën dhe hapësirën e saj si dhe me lagjen/komunitetin dhe zonat rekreative që ofrojnë ato. Siç mund të kuptohet nga grafiku 12 të rinjtë e studimit janë mesatarisht të kënaqur nga banesa e tyre (43.9%) dhe shumë të kënaqur nga hapësira e banesës që jetojnë (42.9%). Vetëm 15.1% në rastin e parë dhe 18.3% në rastin e dytë kanë raportuar kënaqësi të ulët. Ky nivel kënaqësie është më i ulët kur ëshë fjala për lagjen ose komunitetin e tyre. 28.7% e të rinjve janë shumë të kënaqur nga komuniteti që jetojnë dhe 43.2% janë mesatarisht të kënaqur. Përqindja e të rinjve të pakënaqur nga komuniteti dhe lagja janë 28.1%, gati dyfish në raport me banesën. Përqindjet më të larta të pakënaqësisë së të rinjve shihen tek zonat rekreative ose argëtuese që ofron lagja dhe komuniteti ku jetojnë. 63.8% prej tyre janë të pakënaqur nga këto mundësi dhe vetëm 12.4% raportuan se kanë një kënaqësi të lartë, diçka që tregon se të rinjtë kanë nevojë për më shumë mundësi për argëtim dhe për aktivitete rekreative si dhe mjedise të posaçme për t'i realizuar ato. Kënaqësi më të ulët raportojnë të rinjtë e zonave rurale në raport me ata të zonave urbane. Këto rezultate përforcohen nga studime të mëparshme për mënyrën se si të rinjtë shqiptarë shpenzojnë kohën e tyre të lirë, në të cilat është konkluduar se shpesh ata qëndrojnë në kafe, online ose duke parë televizor .<sup>33</sup>

Testi ANOVA ka treguar marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet kënaqësisë nga kushtet e banesës dhe grupmohës, punësimit dhe arsimit ( $\eta^2 = 0.004$ ,  $p = 0.019$ ,  $\eta^2 = 0.006$ ,  $p = 0.002$ , dhe  $\eta^2 = 0.017$ ,  $p < 0.001$ ). Të rinjtë e moshave 18-19 vjeç ishin më të kënaqur se sa ata të

<sup>33</sup> Çela, A. dhe Kamberi, G. (2018). Rinia shqiptare 2018/19. FES Tirana. E marrë nga <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf> e aksesuar në Mars 2019.

Grafiku 12. Kushtet e banesës



moshave më të mëdha (mesatarja 18-19 vjeç = 8, mesatarja mbi 19 = 7.6). Të rinjtë e punësuar (mesatarja = 7.8) dhe ata të papunë (mesatarja = 7.6) kanë një ndryshim në nivelin e kënaqësisë nga kushtet e banesës me ata inaktivë (mesatarja = 6.5). Në lidhje me arsimin, sërish të rinjtë pa arsim mesatarisht nuk ishin të kënaqur nga kushtet e banesës në raport me ata me arsim fillor, të mesëm dhe me universitet (mesataret përkatësisht 5.38, 7.13, 7.74, 7.88). Në të njëjtën linjë me kënaqësinë nga kushtet e banesës, ishin dhe prirjet e kënaqësisë nga hapësira që ka banesa. Lidhjet statistikisht të rëndësishme të këtyre variablave demografike dhe hapësirës së banesës ishin me grupmoshën ( $\eta^2 = 0.007$ ,  $p = 0.007$ ) me punësimin ( $\eta^2 = 0.003$ ,  $p = 0.031$ ) dhe me arsimin ( $\eta^2 = 0.019$ ,  $p < 0.001$ ). Referuar kënaqësisë së perceptuar nga komuniteti ku jetojnë variabla statistikisht domethënëse ishin punësimi ( $\eta^2 = 0.003$ ,  $p = 0.031$ ) dhe arsimi ( $\eta^2 = 0.004$ ,  $p < 0.001$ ). Të rinjtë e punësuar vlerësojnë shumë më tepër lagjen dhe komunitetin dhe janë më të kënaqur me të krahasimisht me të rinjtë inaktivë. Gjithashtu, të rinjtë me arsim të detyrueshëm ose pa arsim kanë më pak kënaqësi nga komuniteti që jetojnë në raport me të rinjtë me shkollë të lartë ose që kanë përfunduar gjimnazin. Në lidhje me kënaqësinë nga zonat rekreative dhe variablat e tjerë, arsimi ka rezultuar statistikisht domethënës ( $\eta^2 = 0.004$ ,  $p = 0.044$ ) ku sërish mesataren më të ulët e kanë ata pa arsim (3.5).


Studime të realizuara në vende të tjera tregojnë se mërzitja nga pamundësia për t'u marrë me aktivitete argëtuese dhe rekreative mund të rritë probabilitetin e përdorimit të substancave narkotike<sup>34</sup>. Rezultatet pozitive të pranisë së hapësirave rekreative dhe argëtuese lidhen me reduktimin e delikuencës në adoleshencë dhe rini, rritjen e sjelljeve pozitive, përmirësimin e performancës në shkollë, reduktimin e obezitetit, socializimin më të madh dhe zhvillimin e vetë – besimit, optimizmit dhe iniciativës<sup>35</sup>. Gjithashtu, çon në reduktimin e orëve të kaluara përpara ekranit (celular, televizor, tabletë, laptop etj.), i cili ka efekte negative tek të rinjtë dhe aktualisht në këtë studim është në nivele shumë të larta.

Në vijim të pyetjes së mësipërme të rinjtë pohojnë se përgjithësisht ndihen mjaft të sigurtë fizikisht në lagjen ose komunitetin që jetojnë (40.5%) ose shumë të sigurtë (27.8%). Nga ana tjetër, duhet të theksohet se rreth 1 në 5 të rinj tregojnë se ndihen pak të pasigurtë (19.2%) dhe një përqindje tjetër ndihen shumë të pasigurtë (8.4%). Të rinjtë e moshës 18-19 vjeç dhe ata që janë me të ardhura të ulëta ekonomike në familje janë më të pasigurt se të tjerët.

<sup>34</sup> Willging, C.E., Quintero, G. dhe Lilliot, E. (2014). Hitting the Wall: Youth Perspectives on Boredom, Trouble, and Drug Use Dynamics in Rural New Mexico. *Youth and Society*, 46 (1): 3 – 29.

<sup>35</sup> Witt, P. dhe Caldwell, L. (2010). The Rationale for Recreation Services for Youth: An Evidenced Based Approach. <https://www.nrpa.org/globalassets/research/witt-caldwell-full-research-paper.pdf>. National Recreation and Park Association.


Grafiku 13. Siguria fizike



Mesatarisht pjesëmarrësit shprehen se nuk janë shumë të kënaqur me gjendjen financiare individuale  $m = 5.6$  (në një shkallë nga 1 deri në 10). Kënaqësi të ulët këtu kanë pohuar 46.1% të pjesëmarrësve, ose gati 1 në 2 të rinj. Në këtë pyetje është interesant fakti se 29.2% e të rinjve të moshës 18-19 vjeç kanë kënaqësi të lartë, në ndryshim të qartë nga ata të moshës 20 – 24 vjeç me kënaqësi të lartë vetëm 12.2% dhe ata të moshës 25 – 29 vjeç me kënaqësi të lartë 13.8%.

Mund të hamendësohet se në moshën 18 – 19 vjeç të rinjtë janë ende pranë familjes dhe nuk kanë për të përballuar kostot e shkollimit në arsimin e lartë. Gjithsesi, ulja e kënaqësisë nga të ardhurat deri në moshën 29 vjeç mund të jetë një tregues i rëndësishëm jo vetëm për papunësinë, por edhe për punën me të ardhura të ulëta në Shqipëri.

Grafiku 14. Kënaqësia nga gjendja financiare individuale






### 4.3. Gjendja emocionale

Në sesionin e tretë është bërë përpjekje për të eksploruar dhe vlerësuar gjendjen emocionale të pjesëmarrësve gjatë muajit të fundit, që do të jepte një panoramë të momentit mbi shëndetin e tyre mendor dhe emocionet.

Së pari, pjesëmarrësit raportuan se gjatë muajit të fundit kanë përjetuar një kënaqësi mesatare me  $m = 7.01$  (në një shkallë nga 1 deri në 10). Kënaqësi të ulët kanë 23.9% e pjesëmarrësve ndërsa mesatare dhe të lartë 76.1%. Kënaqësia ishte në nivele thujtse të barabarta në të gjitha grupmoshat, përveç moshës 20 – 24 vjeç ku ishte pak më e ulët (6.96). Në Dibër dhe në Fier janë raportuar nivelet më të ulëta të kënaqësisë nga të rinjtë (6.45 dhe 6.61 respektivisht), ndërsa më të lartë e kishin ata të Vlorës (7.9) dhe të Korçës (7.51). Sipas grafikut 15 duket se niveli i arsimimit ka një lidhje me kënaqësinë e ndjerë, pasi pjesëmarrësit pa arsim janë ata që kanë patur kënaqësi shumë të ulët (3.85) ndërsa ata me doktoraturë kanë patur nivel më të lartë se mesatarja (8.13). I njëjti ndryshim gjendet dhe në raport me nivelin e të ardhurave, sa më i lartë aq më e madhe kënaqësia e përjetuar. Gjithashtu, ka një ndryshim në kënaqësinë e përjetuar mes pjesëmarrësve të ve dhe të divorcuar - të cilët kanë nivelet më të ulëta - dhe atyre të ndarë por ligjërisht të martuar, që kanë nivelet më të larta.



Në lidhje me marrëdhënien e moshës, gjinisë, punësimit dhe arsimit dhe kënaqësinë e ndjerë gjatë muajit të fundit, domethënie statistikore kishte me punësimin ( $\eta^2 = 0.006$ ,  $p = 0.003$ ) dhe arsimin ( $\eta^2 = 0.013$ ,  $p < 0.001$ ). Të rinjtë e punësuar kishin një kënaqësi më të lartë në raport me ata të papunë dhe inaktivë. Gjithashtu, kënaqësia e të rinjve me studime universitare ishte dy herë më e lartë se sa e atyre pa arsim.

Tabela më poshtë (Tabela 2) tregon se kënaqësia nga jeta e përjetuar gjatë muajit të fundit ka lidhje korrelacionale pozitive mesatare me një sërë faktorësh të tjerë ( $p < 0.001$  në të gjitha rastet). Kështu ajo lidhet me kënaqësinë nga kushtet e banesës ( $r = 0.392$ ), me hapësirën e saj ( $r = 0.36$ , me kënaqësinë nga lagja ose komuniteti që jetojnë të rinjtë ( $r = 0.344$ ), me kënaqësinë nga zona rekreative dhe argëtuese të lagjes ose komunitetit ( $r = 0.259$ ), me kënaqësinë nga gjendja financiare individuale ( $r = 0.416$ ), me kënaqësinë nga puna ( $r = 0.395$ ) dhe me kohën e udhëtimit nga shtëpia në punë ( $r = 0.256$ ). Ajo çfarë përforcohet me këto lidhje është fakti se kënaqësia nga jeta është një përjetim kompleks që ndikohet nga një sërë faktorësh.

**Tabela 2. Korrelacionet mes kënaqësisë nga jeta dhe kushteve të banesës, hapësirës së saj, kënaqësisë nga lagja/komuniteti, gjendjes financiare, punësimit dhe kohës së udhëtimit deri në punë**


Sa të kënaqur jeni me kushtet e banesës tuaj në një shkallë nga 1 në 10?	Pearson Correlation	.392**
	Sig. (2-tailed)	.000
	N	2041
Sa të kënaqur jeni me hapësirën e banesës në të cilën jetoni?	Pearson Correlation	.360**
	Sig. (2-tailed)	.000
	N	2041
Sa të kënaqur jeni me lagjen/komunitetin në të cilin jetoni?	Pearson Correlation	.344**
	Sig. (2-tailed)	.000
	N	2041
Sa të kënaqur jeni me zonat rekreative/argëtuese në lagjen/komunitetin tuaj?	Pearson Correlation	.259**
	Sig. (2-tailed)	.000
	N	2041
Në përgjithësi, sa të kënaqur jeni me gjendjen financiare individuale?	Pearson Correlation	.416**
	Sig. (2-tailed)	.000
	N	2041
Në përgjithësi, sa të kënaqur jeni me punën?	Pearson Correlation	.395**
	Sig. (2-tailed)	.000
	N	1099
Në përgjithësi, sa të kënaqur jeni me kohën e udhëtimit nga shtëpia në punë?	Pearson Correlation	.256**
	Sig. (2-tailed)	.000
	N	1099

\*\* . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

\* . Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).

Në lidhje me përjetimin e ndjenjës së lumturisë gjatë muajit të fundit, shumica e pjesëmarrësve kanë thënë se ishin ndjerë kështu ose disa herë (35.2%) ose shpeshherë (44.8%). E njëjta prirje vihet re dhe në pyetjen “Sa shpesh jeni ndjerë të qetë gjatë muajit të fundit?”, ku sërish shumica e pjesëmarrësve tregojnë se janë ndjerë kështu shpesh (46.1%). Nga ana tjetër, vlen për t’u përmendur se një përqindje e konsiderueshme e pjesëmarrësve janë ndjerë shumë nervozë në mjaft raste gjatë muajit të fundit (58.5%) dhe të rënë moralisht (38.5%). Thuajse 1 në 10 të rinj janë ndjerë të dëshpëruar shumë herë në këtë periudhë (9.3%) (Grafiku 16 36).

Grafiku 16. Gjendja emocionale gjatë muajit të fundit



Përjetimi i lumturisë ka një lidhje interesante me moshën. Të rinjtë e moshës 18 – 19 vjeç dhe ata të moshës 25 – 29 vjeç janë ata që përjetojnë më pak herë lumturinë në raport me të rinjtë e moshës 20 – 24 vjeç. Edhe pse në studim nuk është eksploruar më tej kjo pyetje, mund të lidhet me proceset jetësore dhe tranzicionet e kësaj moshë. Në moshën 18 – 19 vjeç të rinjtë janë në përfundim të shkollës së mesme ose në fillimin e shkollës së lartë, e cila është një periudhë tranzitore dhe sfiduese për ta. E njëjta gjë ndodh dhe në moshën 25 – 29 vjeç, ku të rinjtë sapo kanë përfunduar arsimin e lartë dhe pasuniversitar dhe tashmë duhet të përballen me tregun e punës, të zhvillojnë plane serioze për jetën, për krijimin e familjes së tyre, të marrin përgjegjësi më të mëdha etj. Pjesëmarrësit pa arsim dhe ata të divorcuar gjithashtu kanë raportuar nivele të larta të mungesës së ndjenjës së lumturisë (tek ata pa arsim përgjigjia “asnjëherë” është dhënë në 38.5% të rasteve ndërsa tek të divorcuarit përgjigjia “rrallëherë” ishte dhënë në 46.2% të rasteve). Divorci lidhet dhe me ndjenjën e nervozizmit dhe të një far dëshpërimi, i cili shprehet me rezultate të larta në pyetjet për “rëniën morale” dhe dëshpërimin.


Vajzat e reja, të rinjtë me arsim të ulët, të rinjtë me të ardhura ekonomike familjare të ulëta ndiheshin më shpesh të rënë moralisht. Gjithashtu, të dëshpëruar janë ndjerë më shpesh ata pa arsim (15.4% kanë thënë se janë ndjerë gjithmonë kështu) dhe ata me të ardhura të ulëta familjare ekonomike (15% kanë thënë gjithmonë). Në studime të ngjashme është raportuar se shëndeti mendor ka një lidhje me statusin socio – ekonomik, madje njerëzit me status të ulët socio – ekonomik kanë katër herë më shumë probabilitet që të raportojnë cilësi të ulët të shën-

<sup>36</sup> Për një paraqitje më të mirë, në këtë grafik nuk janë përfshirë rezultatet e alternativave “Nuk e di” dhe “Nuk dëshiroj të përgjigjem” pasi ishin shumë të ulëta.

detit të tyre mendor<sup>37</sup>. Për më tepër, Organizata Botërore e Shëndetit paralajmëron se gjysma e problemeve të shëndetit mendor fillojnë në moshën 14 – vjeçare. Nëse lihen të patrajtuara do të kenë pasoja në jetesën e këtyre të rinjve si të rritur dhe do të kufizojnë mundësitë e tyre për një jetë përmbushëse<sup>38</sup>.

#### 4.4. Marrëdhëniet familjare dhe shoqërore

Në vijim të pyetjeve për gjendjen emocionale të të rinjve pjesëmarrës janë vlerësuar dhe marrëdhëniet që ata/o kanë me anëtarë të familjes, si nëna, babai, motrat dhe vëllezërit. Rezultatet tregojnë se përgjithësisht marrëdhëniet me të gjithë anëtarët e familjes janë shumë të mira, duke qenë se mesatarja është mbi 9 për nënën, motrën/at dhe vëllain/vëllezërit. Është pak më e ulët në rastin e babait, por me një ndryshim të vogël, 8.97. Pjesëmarrësit pa arsim sërish kishin një mesatare më të ulët në marrëdhëniet e tyre me anëtarët e familjes. Këto rezultate janë në një linjë me ato të ngjashme në kontekstin shqiptar, pasi edhe aty konfirmohet se të rinjtë në Shqipëri preferojnë të jetojnë me familjen e tyre, se kanë marrëdhënie të mira me anëtarët e familjes dhe se prindërit janë persona të rëndësishëm për marrjen e vendimeve në jetën e tyre<sup>39</sup>.



Marrëdhëniet me babain, motrën dhe vëllezërit kishin ndryshime statistikiisht të rëndësishme me arsimin e të rinjve ( $p < 0.001$  për të treja ndërsa  $\eta^2$  babai = 0.011,  $\eta^2$  motra/t = 0.015 dhe  $\eta^2$  vëllai = 0.015). Sikundër dhe në pyetje më përpara të rinjtë pa arsim dhe me arsim të ulët kanë mesatare më të ulët në këto marrëdhënie në raport me të rinjtë me arsim të lartë.


<sup>37</sup> Evans, M. (2016). Examining the relationship between socioeconomic status and mental health quality of life in a rural neighborhood context. Thesis. University of Iowa. Marrë nga <https://ir.uiowa.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=6425&context=etd> e aksesuar në Mars 2019

<sup>38</sup> WHO (2018). Adolescent mental health facts. Marrë nga <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/adolescent-mental-health> e aksesuar në Mars 2019

<sup>39</sup> Çela, A. dhe Kamberi, G. (2018). Rinia shqiptare 2018/19. FES Tirana. E marrë nga <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf> e aksesuar në Mars 2019.

Në lidhje me kontaktet e pjesëmarrësve me të afërmit e brezit të parë dhe me miqtë e tyre të rrethit të afërt shoqëror, rezultatet tregojnë se përgjithësisht të rinjtë takohen shpesh me të afërmit (33.1%), por shumë më shpesh me miqtë e tyre (64.1%) (Grafiku 18). Në studimin e Çela dhe Kamberi (2018) rezulton se të rinjtë i konsideronin shumë të rëndësishme marrëdhëniet e tyre me shoqërinë për të qenë të lumtur<sup>40</sup>.

Grafiku 18. Kontakte me të afërmit



#### 4.5. Shkollimi dhe zgjedhja e karrierës

Zgjedhja e karrierës dhe shkollimi janë çështje të rëndësishme që interesojnë dhe shqetësojnë adoleshentët dhe të rinjtë. Fillimisht, të rinjtë janë pyetur në lidhje me kënaqësinë që kishin nga infrastruktura e universitetit ose shkollës që kanë ndjekur, duke iu referuar mjediseve fizike, ambienteve sportive, laboratorëve, bibliotekës dhe kushteve të ngrohjes dhe të ftohjes. Konkretisht, për këtë perceptim të kënaqësisë mund të shihet se kënaqësi të ulët kanë patur 43.1% e pjesëmarrësve për mjediset fizike, 56.5% e tyre për ambjentet sportive, 57.9% për laboratorët, 49.5% për bibliotekën dhe 54.2% për ngrohjen/ftohjen. Këto përqindje tregojnë se mesatarisht gjysma e pjesëmarrësve ishin të pakënaqur nga këto aspekte infrastrukturore të shkollës ose universitetit të tyre (Grafiku 19).


Vlen për t’u përmendur këtu se kënaqësia nga cilësia e mësimdhënies në shkollë ose universitet është më e lartë se ajo me infrastrukturën,  $m = 7.2$ , por sërish në nivelin mesatar. Gjithashtu, pjesëmarrësit mendojnë se tekstet akademike ose shkollore janë të një niveli mesatar (6.9) (Grafiku 20). Qyteti i Dibrës dhe i Shkodrës këtu kanë patur rezultatet më të ulëta në përgjigjet për infrastrukturën e shkollave ose universitetit.

Ndërtesat, klasat, laboratorët dhe pajisjet – infrastruktura shkollore dhe akademike – janë komponentë kritikë të mjediseve të të mësuarit në shkolla dhe universitete. Ka evidenca të forta që tregojnë se infrastruktura e cilësisë së lartë lehtëson mësimdhënien, përmirëson rezultatet


<sup>40</sup> ibid

e studentëve dhe nxënësve dhe redukton ritmet e braktisjes shkollore. Për shembull, në një studim të fundit në Britaninë e Madhe është gjetur se elementët e projektimit dhe dekorimit të shkollës shpjegojnë 16% të ndryshimit në ecurinë akademike. Studimi tregoi se faktorë si natyrshmëria, stimulimi dhe individualizimi janë të rëndësishëm për procesin e të mësuarit<sup>41</sup>.

Grafiku 19. Kënaqësia nga infrastruktura në shkollën /universitet



Grafiku 20. Kënaqësia nga mësimdhënia-tekstet




41 Barrett, P., Treves, A., Shmis, T., Ambasz, D., dhe Ustinova, M. (2018). The impact of school infrastructure for learning: a synthesis of evidence. World Bank Group

### 4.5.1. Frekuentimi i kurseve të ndryshme

Ndër kurset që lidhen me formimin e të rinjve më të frekuentuarat janë ato të gjuhëve të huaja dhe të kompjuterit. Disa prej tyre bëjnë kurse të shkencave ekzakte 1 ose disa herë në javë (8.2%) dhe shumë pak prej tyre kurse të formimit profesional (7.1%). Kurset për gjuhët e huaja dhe për përdorimin e kompjuterit dhe programeve kompjuterike janë më të frekuentuarat në krahasim me kurse të shkencave ekzakte, të formimit profesional dhe të formimit (ndër) profesional (95.1% nuk i frekuentonin këto të fundit).

Grafiku 21. Frekuentimi i kurseve të ndryshme




### 4.5.2. Zgjedhja e karrierës dhe profesionit

Duke patur parasysh rëndësinë që ka profesioni ose zgjedhja e karrierës të rinjtë u pyetën se me kë janë këshilluar përpara se të bënin një zgjedhje të tillë. Në këtë pyetje ata mund të qarkonin më shumë se një alternativë. Kështu pak më shumë se gjysma e tyre (56.4%) janë konsultuar me prindërit. Megjithatë, ia vlen të përmendet se një përqindje e konsiderueshme prej tyre kanë thënë se nuk janë këshilluar me asnjë (36.8%). Diçka tjetër shumë e rëndësishme këtu është ndihmesa shumë e pakët e shkollës (4.1%) ose e qendrave të këshillimit të karrierës në shkollë apo fakultete (1.7%). Gjatë viteve të fundit ka një përpjekje për të fuqizuar komponentin e orientimit për karrierën në shkollat e mesme<sup>42</sup> dhe në fakultete, i cili siç duket ka nevojë akoma për t’u bërë më i pranishëm dhe ndihmues për nxënësit dhe studentët.

<sup>42</sup> Lënda “Edukimi për karrierën” është një nga lëndët e moduleve lëndore me zgjedhje

Grafiku 22. Konsultimi për zgjedhjen e profesionit/karrierës



Orientimi i varfër i dhënë nga strukturat arsimore për zgjedhjen e profesionit ose të karrierës ka çuar në raportimin e kënaqësisë së ulët nga këto struktura, siç shihet në grafikun më poshtë. 48.2% e të rinjve ose rreth 1 në 2 pjesëmarrës janë të pakënaqur nga ndihma e strukturave të shkollës ose të fakulteteve, edhe pse shumica prej tyre janë të kënaqur nga zgjedhja që kanë bërë (Grafiku 23). Një kryqëzim të dhënash mes këtyre pyetjeve (kënaqësia nga strukturat arsimore dhe asaj nga zgjedhja e profesionit dhe e karrierës) tregoi se:

- Të rinjtë që kanë raportuar një nivel të ulët të ndihmës nga strukturat arsimore janë të pakënaqur nga zgjedhja e karrierës ose shkollimit të tyre,
- Të rinjtë që ishin shumë të kënaqur nga strukturat arsimore kanë raportuar se janë gjithashtu shumë të kënaqur dhe nga zgjedhja e karrierës/shkollimit.

Këto rezultate tregojnë se sa i rëndësishëm është orientimi për karrierën nga strukturat arsimore në të gjitha nivelet. Në këtë pyetje ka ndryshime mes qarqeve të ndryshme të studimit, ku në zona si Shkodra ose Durrësi pjesëmarrësit shprehën se ndihmesa ka qenë më e ulët dhe në zona si Fieri ose Berati ishte më e lartë. Kënaqësia nga zgjedhja e arsimimit ose e karrierës është mesatare dhe e lartë (Grafiku 23).


Të rinjtë e zonave rurale janë më pak të kënaqur se ata të zonave urbane me zgjedhjen e arsimimit dhe/ose karrierës së tyre. Ata pa arsim ose me arsim fillor janë më të pakënaqur nga ndihma që i kanë dhënë strukturat arsimore në zgjedhjen e shkollimit, por edhe me shkollimin e tyre aktual. Këtu del në pah rëndësia e një orientimi të duhur në lidhje me vazhdimin e shkollës, por edhe me bërjen e zgjedhjeve të duhura dhe të përshtatshme për të rinjtë.

Sa i përket rezultateve statistikisht domethënëse duket se vajzat kanë marrë më shumë ndihmë nga strukturat arsimore dhe janë më të kënaqura në zgjedhjet e tyre krahasimisht me djemtë ( $p < 0.001$  në të tre pyetjet dhe  $\eta^2$ struktura = 0.005,  $\eta^2$ arsimimi = 0.017 dhe  $\eta^2$ karriera=0.013). Kënaqësia nga zgjedhja e arsimit dhe e karrierës është më e ulët në moshat mbi 19 vjeç. Duket se përballja me realitetin e shkollimit universitar dhe tregun e punës ka një ndikim të qenësishëm për të rinjtë ( $\eta^2$  arsimimi = 0.005,  $p=0.013$ ,  $\eta^2$  karriera = 0.006,  $p=0.007$ ). Të rinjtë e punësuar dhe të papunë sërish kanë një kënaqësi më të lartë krahasuar me të rinjtë inaktivë si në rastin




e arsimit ashtu dhe në rastin e karrierës ( $\eta^2_{\text{arsimimi}} = 0.012$ ,  $p < 0.001$ ,  $\eta^2_{\text{karriera}} = 0.015$ ,  $p = 0.009$ ). Së fundmi, të rinjtë me arsim nëntë-vjeçar dhe pa arsim janë më pak të kënaqur si nga zgjedhja e arsimit, ashtu dhe nga ajo e karrierës por edhe nga ndihma e marrë nga strukturat arsimore. Ndryshimet mes këtyre grupeve janë shumë të mëdha, p.sh. nxënësit me arsim nëntë-vjeçar kanë mesatare rreth 5.6 nga 10 në kënaqësinë nga arsimi dhe karriera ndërsa ata me arsim të lartë rreth 7.6 ( $\eta^2_{\text{arsimimi}} = 0.055$ ,  $\eta^2_{\text{karriera}} = 0.046$ ,  $p < 0.001$  në të dyja rastet).

Grafiku 23. Kënaqësia nga zgjedhjet e profesionit/karrierës



Së fundmi, përsa i përket punësimit të të rinjve 51.4% raportojnë se nuk janë duke punuar, 25.9% se janë duke punuar në një fushë që nuk lidhet me studimet e tyre, 16.7% në fushën ku kanë studiuar dhe 6% në një fushë të përafërt. Këto gjetje tregojnë se praktikisht 1 në 4 të rinj janë duke punuar në punë të tjera, që nuk janë as të përafërta me ato që kanë studiuar. Tregues të tillë janë të rëndësishëm për të kuptuar nivelet e papunësisë në Shqipëri dhe vështirësitë e të rinjve për aksesin në tregun e punës. Gjithashtu, bëhet shumë e rëndësishme përshtatja e kurrikulave shkollorë dhe uiversitare me tregun e punës.


Grafiku 24. A lidhet puna aktualisht që po bëni në fushën në të cilën keni studiuar



## 4.6 Kënaqësia në përdorimin e kohës së lirë

Një fushë e rëndësishme mbi të cilën është eksploruar në studim ishte koha e lirë, ku të pyetur në një shkallë vlerësuese nga 1 “aspak i kënaqur” në 10 “plotësisht i kënaqur”, vetëm 30.8 % e të rinjve raportojnë kënaqësi të lartë në kalimin e kohës së lirë ku 58 % prej tyre jetojnë në zonat urbane. Nga kjo përqindje duket se djemtë janë më të kënaqur me kohën e lirë krahasuar me vajzat (58.6 %) dhe 37.8 % i përkasin grupmoshës 20-24 vjeç. Ndërkohë 41.8 % kanë raportuar një nivel kënaqësie mesatare dhe 27.4 % e të rinjve kanë raportuar se kanë me  $p < 0.001$  dhe një kënaqësi të ulët në kalimin e kohës së lirë (Grafiku 25). Diferencat midis kënaqësisë më të lartë në kalimin e kohës së lirë mes djemve krahasuar me vajzat lidhen me mungesën e llojshmërisë së mundësive për kalimin e kohës së lirë për vajzat kryesisht në zonat rurale ku edhe dalja me miqtë është shumë e ulët <sup>43</sup>.

Grafiku 25. Kënaqësia në përdorimin e kohës së lirë




Nga të rinjtë të cilët kanë raportuar një nivel kënaqësie mesatare në kalimin e kohës së lirë 43.1 % e tyre janë me arsim të mesëm, 27.6 me arsim të lartë bazë dhe 11.3 % me arsim pas universitar. Ndërkohë të ndara sipas statusit, 72.1% e pjesëmarrësve që kanë raportuar një nivel mesatar kënaqësie janë beqarë dhe 21.3 % të martuar. Sipas qarqeve nivelet më të ulta të kënaqësisë janë raportuar në Dibër (14.6%), Gjirokastër (11.2%) dhe Lezhë (11%) dhe nivelet më të larta të kënaqësisë lidhur me kalimin e kohës së lirë në Kukës (16.9%), Vlorë (12.8 %) dhe në Fier (10.8 %).

<sup>43</sup> Çela, A. dhe Kamberi, G. (2018). Rinia shqiptare 2018/19. FES Tirana. E marrë nga <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf> e aksesuar në Mars 2019.

### 4.6.1 Të rinjtë dhe aktivitetet kulturore


Grafiku 26. Frekuentimi i aktiviteteve kulturore



Referuar grafikut 26 mbi aktivitetet e kohës së lirë lidhur me frekuentimin e kinemave, 77.7 % e të rinjve të pyetur janë shprehur se nuk i frekuentojnë dhe 10.5 % e tyre janë shprehur se i frekuentojnë më rrallë se një herë në muaj. Po ashtu në nivele të larta është edhe mosfrekuentimi i teatrit (85.8 %), ekspozitave (89.6 %) dhe muzeve (87.4 %) nga të rinjtë. Kjo lidhet edhe me mungesën e këtyre mundësive në të gjithë vendin ku janë pyetur të rinjtë. Një rezultat domethënës duket se është edhe marrëdhënia e të rinjve me leximin e librave, ku 51.3 % e tyre janë shprehur se nuk lexojnë asnjëherë libra, 23.7 % lexojnë libra më shumë se një herë në muaj dhe 13.1 % e të rinjve lexojnë më rrallë se një herë në muaj. Nga të rinjtë të cilët janë shprehur se lexojnë të paktën një herë në muaj, 64.2 % janë vajza kryesisht të grupmoshës 20-24 vjeç dhe 54.7 % e tyre jetojnë në zonat urbane. Këto rezultate duket se janë në të njëjtën linjë edhe me studimin e Çela dhe Kamberi (2018) ku rezulton se vetëm një e treta e të rinjve shpenzon rregullisht kohë të lirë duke lexuar libra.<sup>44</sup>

### 4.6.2 Të rinjtë dhe aktivitetet sportive

Grafiku 27. Frekuentimi i aktiviteteve sportive



<sup>44</sup> Çela, A. dhe Kamberi, G. (2018). Rinia shqiptare 2018/19. FES Tirana. E marrë nga <http://library.fes.de/pdf-files/bucros/albanien/15257.pdf> e aksesuar në Mars 2019.


Situata e frekuentimit të aktiviteteve sportive nga të rinjtë duket se nuk është më pozitive se ajo me aktivitetet kulturore ku siç shihet edhe nga grafiku 27, vetëm 15.5 % e të rinjve janë shprehur se luajnë futboll, 6.9% frekuentojnë rregullisht palestrën dhe 5.6 % luajnë volejboll të paktën njëherë në javë dhe në përqindje më të ulëta aktivitetet e tjera.

Problematike mbetet situata ku përqindja më e madhe e të rinjve të pyetur nuk frekuentojnë aktivitetet sportive si futboll (68.8 %), basketboll (91.3 %), volejboll (87,1%), not (93 %), pal-estër (74.4 %).

### 4.6.3 Të rinjtë, arti dhe kultura

Lidhur me frekuentimin e kurseve artistike dhe kulturore mbi 90 % e të rinjtë janë shprehur se nuk frekuentojnë asnjë prej tyre si në vijim: pikturë 95.3 %, instrumente muzikore 95.6 %, balet/kërcim 96.6 % dhe fotografi 92.1 %. Vetëm 3.9 % e tyre janë shprehur se frekuentojnë një kurs fotografie më shumë se dy herë në muaj. Më shumë se gjysma e të rinjve që nuk frekuentojnë asnjë nga aktivitetet e mësipërme i përkasin grupmoshës 20-24 vjeç dhe 54.2 % jetojnë në zonat urbane. Kjo lidhet me mungesën e ofertës për aktivitete të tilla në të gjithë territorin e vendit, jo vetëm në zonat rurale por edhe në ato urbane, si edhe me faktin që ofrohen kundrejt pagesës çka i bën të pa përballeshme për shumicën e të rinjve. Gjithashtu, Qendrat Kulturore në shumicën e Bashkive janë të munguara apo nuk funksionojnë në kapacitet të plotë bazuar në nevojat e të rinjve.

Grafiku 28. Frekuentimi i aktiviteteve artistike



#### 4.6.4 Të rinjtë dhe aktivitetet vullnetare

Grafiku 29. Pjesëmarrje në aktivitetet vullnetare



Aktivizimi në aktivitetet vullnetare duket se është në nivele shumë të ulëta tek të rinjtë shqiptarë, ku më shumë se 70% e të rinjve pjesëmarrës nuk marrin pjesë në asnjë lloj aktiviteti vullnetar. Prej tyre 45.2 % janë djem dhe 54.8 vajza. Nga të rinjtë që marrin pjesë në aktivitetet vullnetare rezultojnë se 29.2 % marrin pjesë në aktivitetet dhe organizime bamirësie, 22.9 % në organizime me bazë fetare, 18.6 % marrin pjesë në aktivitetet vullnetare të organizuara nga partitë politike apo sindikatat, 14.1 % e tyre kanë raportuar se marrin pjesë në aktivitetet të organizuara nga organizatat e shoqërisë civile dhe vetëm 11.6% e të rinjve marrin pjesë në organizime të shoqatave profesionale (Grafiku 29). Këto të dhëna janë në linjën e prirjes së pjesëmarrjes sociale të të rinjve ku në të gjithë Shqipërinë vetëm 16% e të rinjve angazhohen në aktivitetet vullnetare.<sup>45</sup> Gjithashtu, vlen për t'u theksuar se pjesëmarrja më e lartë e të rinjve në aktivitetet bamirësie dhe fetare dhe e ulët në aktivitetet e partive politike apo të shoqërisë civile mund të tregojë zhgënjimin e tyre nga këto sisteme – parti politike dhe shoqëri civile – dhe kthimin e interesit të tyre drejt aktiviteteve që kanë impakt të prekshëm dhe të drejtpërdrejtë tek grupet në nevojë.


#### 4.6.5 Të rinjtë, koha e lirë, media dhe rrjetet sociale

Një çështje e eksploruar mbi kalimin e kohës së lirë nga të rinjtë lidhet me kohën e kaluar duke parë televizor, përdorimin e internetit dhe përdorimin e mediave sociale. Siç shihet edhe në grafikun 30, 68.9% e të rinjve janë shprehur se kalojnë më pak se tre orë në ditë duke parë televizor, pa ndryshime mes zonave rurale dhe urbane dhe ndërmjet gjinive. Një përqindje të konsiderueshme zë edhe përdorimi i internetit si një mjet informues pa përfshirë rrjetet sociale, ku 50.4% e të rinjve janë shprehur se kalojnë më pak se tre orë kohë në internet dhe 38.1 % e tyre janë shprehur se nuk shpenzojnë fare kohë në internet (Grafiku 30). Kjo përqindje nuk ka shumë diferencë mes të rinjve të zonave urbane (50.4%) dhe atyre të zonave rurale (49.6 %).

Në përqindje më të larta është përdorimi i rrjeteve sociale nga të rinjtë si një mënyrë e kalimit të kohës së lire. 20.5% janë shprehur se kalojnë më shumë se 3 orë në ditë në facebook, 32.3% në Instagram dhe 17.6 % në Youtube (Grafiku 30). Të rinjtë e zonave rurale që kalojnë më shumë kohë në facebook duket se janë më shumë krahasuar me ato të zonave urbane, 54.2% e të

<sup>45</sup> Youth Bank Hub (2017). Pjesëmarrja Politike, Sociale dhe Ekonomike e të Rinjve në Shqipëri. Raport vjetor. Marrë nga [https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2017/06/raporti\\_vjetor\\_YBH-shqip.pdf](https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2017/06/raporti_vjetor_YBH-shqip.pdf) e aksesuar në Prill 2019.

Grafiku30. KOHA E EKTRANIT



rinjve të zonave rurale kanë deklaruar se qëndrojnë në facebook 2-3 orë në ditë, ku më shumë se gjysma janë djem dhe i përkasin grupmoshës 20-24 vjeç. Gjetjet janë të ngjashme me ato të studimeve të mëparshme mbi rininë shqiptare ku është konkluduar se të rinjtë kalojnë shumë kohë online (3.9 orë në ditë) dhe duke parë televizor (2.3 orë në ditë).<sup>46</sup>

Siç vihet re edhe nga grafiku, rrjetet sociale të cilat kanë një profil profesional si Twitter, LinkedIn kanë një shkallë përdorimi të ulët nga të rinjtë, ku 86.8 % e të rinjve kanë deklaruar se nuk e përdorin fare LinkedIn dhe 79.4 se nuk përdorin rrjetin social Twitter.

#### 4.7. Aksesi në shërbime dhe besimi tek institucionet

Një fushë e rëndësishme e vlerësuar gjatë studimit lidhet me individët/institucionet ku të rinjtë drejtohen në rastet kur diçka i shqetëson apo që kanë nevojë për ndihmë. Institucionet e besimit kryesojnë tek gjetjet për këtë pyetje, pasi 100% e të rinjve raportojnë se do kërkonin ndihmë tek këto institucione në një situatë shqetësuese. (Grafiku 31). Grupmosha dominuese këtu është ajo 20-24 vjeç (43.8%) dhe pa shumë diferenca mes zonave rurale (49.9%) dhe atyre urbane (50.1%). Gjithashtu, lidhur me nivelin arsimor të të rinjve të cilët do të kërkonin ndihmë tek institucionet e besimit, rezultojnë se 43.4 % e tyre janë me arsim të mesëm dhe 25.2 % me diplomë universitare bazë/bachelor. Studimi i IDM/Pasos (2015) që maste nivelin e besimit tek institucione me bazë fetare gjeti se 1 në 2 shqiptarë të anketuar kishin besim tek institucionet fetare. Përqindjet aktuale të të rinjve të studimit janë akoma edhe më të larta.<sup>47</sup>


Nga studimi rezultoi se familja dhe familjarët e tyre janë alternativa e dytë për t'u drejtuar në një situatë të tillë sipas 85.6 % e të rinjve. Pjesa tjetër e tyre nuk e shikojnë familjen dhe të afërmit si një mundësi për zgjidhjen e problemeve të tyre (Grafiku 31).

Shqetësues duket fakti që 95.9 % e të rinjve nuk i drejtohen një ndihme të specializuar siç mund

<sup>46</sup> Çela, A. dhe Kamberi, G. (2018). Rinia shqiptare 2018/19. FES Tirana. E marrë nga <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf> e aksesuar në Mars 2019.

<sup>47</sup> IDM/Pasos (2015), "Sondazhi i opinionit publik - Besimi në qeveri"

Grafiku30. Mbështetja në situata shqetësuese



të jetë p.sh. mjeku, infermierja, punonjësi social, etj. pavarësisht nivelit arsimor, gjinisë dhe zonës.

Gjithashtu 28.2% e të rinjve janë shprehur se do iu drejtoheshin miqve të tyre në një situatë nevojë për ndihmë dhe në përqindje më të ulta kolegëve të punës (4.7%) dhe linjave telefonike të specializuara (3.2 %) (Grafiku 31). Nevoja për një promovim dhe informim në popullatë mbi shërbimet e specializuara siç janë edhe linjat telefonike mbeten evidente.


#### 4.7.1 Të rinjtë dhe besimi tek institucionet

Besimi i të rinjve tek institucionet ishte një fushë tjetër e rëndësishme e këtij studimi. Niveli i tyre i besimit është ndarë në: i ulët, mesatar dhe i lartë. Nga grafiku 32 vihet re se të rinjtë kanë besim shumë të ulët tek institucione si Avokati i Popullit (67.4%), njësitë administrative (66%), institucionet e drejtësisë (65.8%), Bashkitë (63%), shërbimet sociale publike (62.9%) dhe media (62.1%). Tek institucionet me më shumë besim kryesojnë institucionet e besimit si xhamia ose kisha (27.3%) dhe ato ndërkombëtare (18%). Megjithatë, ajo çfarë konstatohet është një humbje e besimit dhe ndoshta zhgënjim i të rinjve ndaj institucioneve publike por edhe private të sektorëve të ndryshëm.

Domethënëse duket gjetja e një besimi shumë të ulët të të rinjve tek institucionet e qeverisjes vendore sic janë Njësitë Administrative dhe Bashkitë ku presupozohet që janë institucionet e vetme më pranë nevojave të qytetarëve. Kjo gjetje mund të lidhet me shërbimet e ofruara për qytetarët nga këto institucione, të cilat bazohen në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, më së shumti ofrohen në nivelin qendror të bashkisë dhe ato në njësi lidhen kryesisht me dorëzim dokumentacioni për pronësinë, përfitimin nga pagesat e ndihmës ekonomike apo të paaftësisë dhe më pak shërbime të drejtpërdrejta.

Gjithashtu, siç u tha dhe më sipër, të rinjtë kanë një nivel të ulët besimi ndaj institucioneve arsimore publike dhe private (51.5% dhe 53.5% respektivisht), institucionet shëndetësore pub-

Grafiku 32. BESIMI TEK INSTITUCIONET



like dhe ato private (56.5% dhe 46.9% respektivisht) dhe shërbimet sociale publike dhe ato private ose OJF-të (62.9% dhe 61.3%). Përveç institucioneve arsimore, në rastet e tjera ka një besim më të ulët ndaj institucioneve publike të ofrimit të shërbimit shëndetësor dhe social. Në mbështetje të këtyre rezultateve janë dhe nivelet e ulëta të besimit tek spitalet (57.6%) dhe tek institucionet e drejtësisë (65.8%).


Duket se institucionet të cilat kanë shkallën më të ulët të besimit vazhdojnë të jenë të njëjtat me të dhënat e vitit 2015, ku sipas sondazhit mbi besimin e publikut tek institucionet rezultojnë se institucionet e drejtësisë dhe institucionet e sistemit arsimor po përballen me një rënie të besimit publik që prej vitit 2013 <sup>48</sup>.



## 4.8 Të rinjtë dhe emigrimi

Një fushë tjetër e rëndësishme mbi të cilën u eksplorua në studim lidhej me të rinjtë dhe emigracionin. Nga 2041 të rinj që u përfshinë në studim 35.8 % kishin emigruar të paktën një herë nga Shqipëria dhe 64.2 % e të rinjve nuk kishin emigruar ndonjëherë (Grafiku 33). Nga këta të rinj që kanë tentuar të emigrojnë më parë nga Shqipëria, 58.8 % janë djem ku mbizotërojnë zonat rurale me 53.9 % të tyre dhe 41.5 % e tyre me arsim të lartë (bachelor, master dhe doktoraturë). Gjithashtu, nga këta të rinj të cilët kanë tentuar emigracionin, 30% vijnë nga familje të cilat kanë të ardhura mujore nga 35 001 – 87 000 lekë dhe 29% nga familje me të ardhura mujore 18 001 – 35 000 lekë.

Grafiku 33. Shkalla e emigrimit jashtë vendit



Të pyetur më tej nëse kanë menduar ndonjëherë të largohen nga Shqipëria, vetëm 19.9 % e të rinjëve shprehen se nuk e kanë menduar ndonjëherë, 52.1% e të rinjve janë shprehur se e kanë menduar dhe kanë ndërmarrë hapa konkretë për ta realizuar dhe 22.6 % e kanë menduar pa ndërmarrë hapa konkretë. Pra, në total 74.7 % e të rinjve të përfshirë në studim e kanë menduar largimin nga Shqipëria. Kjo e dhënë është në të njëjtën linjë edhe me rezultatet e Gallup International të Nëntor 2018 ku 79% e të rinjve shqiptarë nga 15-29 vjeç raportuan se dëshirojnë të largoheshin përgjithmonë nga Shqipëria<sup>49</sup>.

Nga të rinjtë që kanë ndërmarrë hapa konkretë për t'u larguar nga Shqipëria 43% e tyre janë me arsim të mesëm, 26.7 % me arsim të lartë universitar dhe 16.7 % me arsim të lartë pasuniversitar dhe doktoraturë. Ata vijnë kryesisht nga familje me të ardhura mujore 35,001 deri në 87,000 Lek (32.7 % prej tyre) dhe 18,001 deri në 35,000 Lek (26.5 %). Përqindja e konsiderueshme e të rinjve që vijnë nga familje me të ardhura mesatare jo minimale është një tregues për prirjen e emigrimit gjatë viteve të fundit në Shqipëri, i cili dominon më shumë tek shtresat e mesme


<sup>49</sup> Gallup's Migration Research Center (2018). Measuring our world in motion. Marrë nga <https://news.gallup.com/poll/245225/gallup-migration-research-center.aspx> e aksesuar në Prill 2019.

socio – ekonomike.

Nga të rinjtë që e kanë menduar largimin nga Shqipëria por nuk kanë ndërmarrë hapa konkretë, pjesa më e madhe bëjnë pjesë në grupmoshën 20-24 vjeç (43.9 %) dhe në atë 25-29 vjeç (33.1 %).

Lidhur me arsyet e largimit për ata që e kanë menduar largimin nga Shqipëria, 50.3 % kanë menduar largimin për arsye punësimi, 13.9 % për arsye arsimimi dhe 3.8 % për arsye sigurie. Fakti që më shumë se gjysma e të rinjve të intervistuar e kanë menduar emigrimin për arsye punësimi shpjegohet me shkallën e papunësisë tek të rinjtë, e cila sipas INSTAT në tremujorin e katërt të 2018 ishte 22.3 %.<sup>50</sup>

Grafiku 34. Mendimi për largimin nga Shqipëria




#### 4.9 Të rinjtë dhe vlerat

Një fushë tjetër e rëndësishme studimi është marrëdhënia e të rinjve me vlerat dhe sistemi vleror që ata kanë ndërtuar. Lidhur me vlerën e gjërave që bëjnë në jetën e tyre të rinjtë kanë raportuar një nivel mesatar të saj. Shqetësues është fakti se në total 29.5 % e të rinjve janë shprehur në një nivel të ulët për vlerën e gjërave me të cilat ata merren në përditshmërinë e tyre (Grafiku 35).

Nga të rinjtë dhe të rejtat që janë shprehur se gjërat që ato bëjnë janë shumë të vlefshme 43.5% i përkasin grupmoshës 20 -24 vjeç, 55.2% jetojnë në zonat urbane dhe 41.5 % janë me arsim të mesëm. Një përqindje e konsiderueshme prej tyre vijën nga familje me të ardhura mesatare 35 001 – 87 000 Lekë (32.8%).

<sup>50</sup> INSTAT 2018- Anketa Tremujore e Forcave të Punës –T4\_2018. E marrë nga <http://www.instat.gov.al/media/5305/atfp-t4-2018.pdf> e aksesuar në Prill 2019.


Grafiku 35. Vlera e gjërave që bëjë të rinjtë sipas gjinisë



Në një shkallë nga 1-5 ku 1 - shumë e rëndësishme dhe 5 - aspak e rëndësishme, të rinjtë kanë vlerësuar si shumë të rëndësishme të qenit të shëndetshëm (93.6% e tyre), punësimin (92.1%), të qenit të lumtur (91.7%), të pasurit e një marrëdhënieje të lumtur (90.6%) dhe jetesën në një mjedis të shëndetshëm (89.6%). Ndërkohë që në rezultatet domethënëse për rëndësinë mbeten edhe të ndjerit të sigurtë (86.6) dhe të vlerësuar (84.6%) në vendin e tyre dhe pasja e fëmijëve (85.8%). Vetëm 56.9% prej tyre mendojnë se qëndrimi në Shqipëri është diçka shumë e rëndësishme, një gjetje konsistente me ato më sipër mbi mendimin për largimin nga Shqipëria (Grafiku 36).


Gjërat materiale, si pasja e një makine, e një shtëpie dhe e shumë parave kanë më pak përparësi për të rinjtë e këtij studimi, çka tregon se orientimi i tyre aktualisht është drejt vlerave më të larta dhe jo ndaj atyre materialiste.

Grafiku 36. ÇFARË ESHTË E RËNDËSISHME



## 4.10 Të rinjtë dhe e ardhmja

Grafiku 37. Shqetësimet për të ardhmen



Shqetësimet e të rinjve për të ardhmen përbënin një pjesë të rëndësishme të pyetësorit dhe të studimit. Gjetjet treguan se të rinjtë janë jashtëzakonisht të shqetësuar për papunësinë (83%), varfërinë (81%) dhe rritjen e çmimeve (76 %). Në përqindje të konsiderueshme ishte shqetësimi i tyre për korrupsionin (69 %), dhunën dhe krimin (65%) dhe dhunën në familje (64%), shtimin e sëmundjeve (65 %) dhe në përqindje më të ulët për lindjen e partive të krahut të majtë apo të djathtë, luftrat brenda dhe jashtë Evropës, terrorizmin etj.

Shqetësimet e tjera kryesore të të rinjve për të ardhmen e tyre janë si më poshtë:

- Mungesa e transparencës në të gjitha nivelet institucionale duket se është shqetësuese për të rinjtë, ku 54 % kanë raportuar se janë shumë të shqetësuar dhe 17% disi të shqetësuar;
- Të rinjtë treguan se janë shumë të shqetësuar për hendekun midis të pasurve dhe të varfërve (57%);
- Mungesa e meritokracisë duket se i shqetëson të rinjtë kur mendojnë për të ardhmen e tyre ku 48% u shprehën shumë të shqetësuar dhe 18 % disi të shqetësuar;
- 52 % e të rinjve shqetësohen shumë në lidhje me paragjykimin dhe diskriminimin dhe mungesën e barazisë gjinore që mund të ekzistojë në të ardhmen e tyre.
- Terrorizmi duket se është një çështje që shqetëson të rinjtë shqiptarë kur mendojnë për të ardhmen e tyre, ku 53% prej tyre janë shumë të shqetësuar.
- Presioni politik (57%) dhe diktatura (55%) duket se kanë një vend të konsiderueshëm në shqetësimet e të rinjve për të ardhmen e tyre.

# 5.

## KONKLUZIONET

Studimi “Të rinjtë në Shqipëri” kishte si synim që të jepte një panoramë të situatës së të rinjve 18 – 29 vjeç dhe të cilësisë së jetës së tyre. Morën pjesë të rinj e të reja nga 12 qarqe të Shqipërisë, nga zonat rurale dhe urbane.

Gjetjet e studimit tregojnë se ka një prirje nga të rinjtë për të jetuar me familjen e origjinës (80%). Këto gjetje janë në koherencë me prirjet ndërkombëtare të rikthimit në familje shumë – brezore, që vijnë si rrjedhojë e vështirësive ekonomike për të përballuar jetën vetëm, e vazhdimin të studimeve deri në një moshë më të madhe se më përpara, e vështirësive për punësim, por edhe e mentalitetit në lidhje me jetesën vetëm. Nëse në vendet e tjera janë vajzat që jetojnë më shumë vetëm, në Shqipëri janë djemtë ata që kryesojnë në këtë kategori. Siç duket, mentaliteti patriarkal në Shqipëri ende nuk toleron që vajzat të jenë aq të emancipuara sa të jetojnë larg familjes së origjinës.

Gjendja ekonomike e familjeve të pjesëmarrësve të studimit paraqitet e vështirë, pasi një përqindje e konsiderueshme kanë raportuar të ardhura të ulëta. Arsimi i ulët dhe papunësia kanë lidhje të zhdrejtë me nivelin e të ardhurave dhe sigurisht me kënaqësinë që kanë patur pjesëmarrësit nga gjendja e tyre financiare. Rëndësia e arsimit në gjetjen e punës është evidentuar që kaheerë dhe përforcohet sërish në këtë studim. Natyrisht, gjetja e punës më pas mund të çojë në rritjen e të ardhurave.

Nga ky studim rezulton se përqindja e atyre që kishin përfunduar arsimin profesional ishte shumë e ulët (5.7%). E ngjashme ishte situata me ata që kishin realizuar kurse të formimit profesional (24.8%). Kjo panoramë tregon se të rinjtë ende nuk orientohen drejt formimit të tyre profesional përtej hallkave të shkollimit, por as nuk preferojnë arsimin profesional. Në vendet e BE – së ky raport regjistrimi në kurse të formimit profesional është më i lartë.<sup>51</sup> Ndërkohë, në kontekstin shqiptar studimi i Dumani et al. (2018) tregon se për njerëzit mbi moshën 21 vjeçare ata që kanë përfunduar arsimin profesional janë 3 herë më pak të varfër nga ata me gjimnaz të përgjithshëm dhe mesatarisht më të varfër se ata me arsim të lartë<sup>52</sup>.

Punësimi i të rinjve në studim ishte në shkallën 31.4% ndërsa papunësia – përjashtuar ata që ishin studentë dhe/ose nxënës – ishte 17%. Shumica e të rinjve që punonin ishin në një punë me kohë të plotë dhe kryesisht në sektorin e shitjeve dhe shërbimeve. Të rinjtë ishin të kënaqur mesatarisht nga puna e tyre por më të pakënaqur me kohën e udhëtimit nga shtëpia në punë. Studimi tregoi se të rinjtë janë mesatarisht të kënaqur nga banesa e tyre dhe nga hapësira që ajo ka. Një ulje e ndjeshme e kënaqësisë u vu re në raport me zonat rekreative dhe argëtuese që ofrojnë lagjet ose komunitetet, veçanërisht në zonat rurale. Rëndësia e këtyre hapësirave është evidentuar në studime të mëparshme, si për të reduktuar kohën e kaluar para ekranit (screen time) por edhe për të zhvilluar aspekte fizike e psikosociale të të rinjve. Në lidhje me sigurinë fizike, të rinjtë e moshës 18-19 vjeç dhe ata që janë me të ardhura të ulëta ekonomike në familje janë disi më të pasigurtë se të tjerët.

Në përgjithësi, të rinjtë pjesëmarrës ishin të kënaqur gjatë muajit të fundit, të qetë dhe të lumtur. Mirëpo, një ndryshim vihet re në moshat 18 – 19 vjeç dhe 24 – 25 vjeç ku janë dhe tranzicionet nga shkolla e mesme në atë të lartë dhe nga shkolla e lartë në tregun e punës. Këto tranzicione shoqërohen me ulje të lumturisë. Ndjenja si nervozizmi dhe dëshpërimi nuk janë ta panjohura dhe të papërjetuara nga të rinjtë e këtij studimit, ata ndiheshin shpesh nervozë dhe 1 në 10 prej tyre janë ndjerë shpeshherë të dëshpëruar. Të ardhurat ekonomike dhe arsimi i ulët janë sërish dy faktorë të rëndësishëm në përjetimin e dëshpërimit dhe moralit të ulët.

<sup>51</sup> UNESCO Institute for Statistics. Të dhëna për arsimin. Marrë nga [http://data.uis.unesco.org/Index.aspx?datasetCode=EDULIT\\_DS](http://data.uis.unesco.org/Index.aspx?datasetCode=EDULIT_DS) e aksesuar në Mars 2019

<sup>52</sup> Dumani, B., Bici, R., Dumani, N., Subashi, B. dhe Kondi, A. (2018). Dissemination of Demographic and Socio-Economic Developments in Tirana ëith Special Attention to Youth Education. *Journal of Educational and Social Research*, 8 (2).

Nga studimi rezultoi se të rinjtë kanë marrëdhënie të mira me anëtarët e familjes së tyre. Gjithashtu, ata takohen shpesh me të afërmit e brezit të parë, por akoma më shpesh me shoqërinë e tyre. Rëndësia e shoqërisë për të rinjtë është mbështetur dhe nga studime të tjera të ngjashme<sup>53</sup>.

Një gjetje kritike e studimit ka qenë kënaqësia e pjesëmarrësve nga infrastruktura shkollore ose universitare, domethënë nga mjedisi fizik, ambientet sportive, laboratorët, biblioteka dhe kushtet e ngrohjes dhe të ftohjes: ata tregojnë për kënaqësi mesatare ose të ulët nga të gjitha këto. Cilësia e mësimdhënies dhe e përmbajtjes së teksteve ishte në nivele më të larta. Rëndësia e cilësisë së infrastrukturës është evidentuar dhe në studime të tjera, pasi përmirëson rezultatet e studentëve dhe nxënësve dhe redukton ritmet e braktisjes shkollore.<sup>54</sup>

Përsa i përket orientimit për shkollimin ose për karrierën familja mbetet institucioni kryesor ku këta të rinj bazohen për të marrë vendimet e tyre. Është për t'u theksuar se strukturat shkollore dhe qendrat e këshillimit në shkolla apo fakultete janë ato më pak ndihmuese më përqindjet më të ulëta. Për më tepër, eksplorimi i lidhjeve të mundshme tregon se ata pa arsim ose me arsim fillor janë më të pakënaqur nga ndihma që i kanë dhënë strukturat arsimore në zgjedhjen e shkollimit, por edhe me shkollimin e tyre aktual. Këtu del në pah rëndësia e një orientimi të duhur në lidhje me vazhdimin e shkollës por edhe me bërjen e zgjedhjeve të duhura dhe të përshatshme për të rinjtë.

Të rinjtë që kanë raportuar një nivel të ulët të ndihmës nga strukturat arsimore tregojnë se janë të pakënaqur nga zgjedhja e karrierës ose shkollimit të tyre, sikundër ata që kanë thënë se janë shumë të kënaqur kanë raportuar se janë gjithashtu shumë të kënaqur dhe nga zgjedhja e karrierës/shkollimit. Ata që kanë qenë të kënaqur nga ndihma e strukturave shkollore ishin të kënaqur dhe nga shkollimi apo karriera e tyre aktuale. Këto rezultate tregojnë se sa i rëndësishëm është orientimi për karrierën nga strukturat arsimore në të gjitha nivelet.

Lidhur me kalimin e kohës së lirë më shumë se 1 e 4 e të rinjve raportojnë nivele të ulëta të kënaqësisë në kalimin e kohës së lirë dhe mbi 75% e të pyeturve raportojnë se nuk frekuentojnë aktivitetet kulturore si teatri, muzetë, ekspozitat dhe kinematë. Kjo e dhënë është po ashtu e njëjtë edhe me frekuentimin e aktiviteteve sportive dhe kurseve të ndryshme artistike.

Aktivizimi në aktivitete vullnetare duket se është në nivele shumë të ulëta tek të rinjtë shqiptarë, ku më shumë se 70% e të rinjve të pyetur nuk marrin pjesë në asnjë lloj aktiviteti vullnetar. Këto rezultate janë në një linjë me prirjen e pjesëmarrjes sociale të të rinjve ku në të gjithë Shqipërinë vetëm 16% e të rinjve angazhohen në aktivitete vullnetare.<sup>55</sup>

Përsa i përket përdorimit të internetit dhe kohës së lirë të rinjtë shqiptarë kalojnë një kohë të konsiderueshme në internet dhe kryesisht në rrjetet sociale ku 1 në 2 të rinj raportuan se kalojnë nga 1-3 orë në facebook gjatë ditës. Kjo prirje është e ngjashme edhe me studime të mëparshme ku të rinjtë kalojnë kalojnë shumë kohë online (3.9 orë në ditë).<sup>56</sup>

Të rinjtë shqiptarë në një situatë kur kanë nevojë për ndihmë ato kanë raportuar se institucio-

<sup>53</sup> Çela, A. dhe Kamberi, G. (2018). Rinia shqiptare 2018/19. FES Tirana. E marrë nga <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf> e aksesuar në Mars 2019.

<sup>54</sup> Barrett, P., Treves, A., Shmis, T., Ambasz, D., dhe Ustinova, M. (2018). The impact of school infrastructure for learning: a synthesis of evidence. World Bank Group

<sup>55</sup> Youth Bank Hub, Raport Vjetor (2017). Pjesëmarrja Politike, Sociale dhe Ekonomike e të Rinjve në Shqipëri

<sup>56</sup> Çela, A. dhe Kamberi, G. (2018). Rinia shqiptare 2018/19. FES Tirana. E marrë nga <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf> e aksesuar në Mars 2019.



net e besimit si kisha apo xhamia (100%) dhe familjarët e tyre (85.6 %) janë opsionet ku të rinjtë

drejtohen më së shumti në një situatë të tillë. Nga rezultatet e studimit u vu re se shërbimet dhe profesionistët e specializuar për ofrimin e ndihmës janë ata që kontaktohen ndoshta të fundit në kësi rastesh, pasi 95.9 % e të rinjve nuk i drejtohen një ndihme të specializuar si mjekut, infermieres, punonjësit social etj.

Besimi tek institucionet vazhdon të jetë i ulët në sytë e të rinjve shqiptarë. Institucionet tek të cilat të rinjtë kanë një besim të ulët janë ato të drejtësisë, avokati i popullit, shërbimet arsimore, shëndetësore dhe sociale publike dhe private dhe bashkitë. Krahasuar me studime të mëparshme besimi tek institucionet arsimore dhe ato të drejtësisë kanë një prirje në rënie. Më shumë se gjysma e të rinjve të pyetur kanë raportuar se e kanë menduar largimin nga Shqipëria dhe kanë në ndërmarrë hapa konkretë për ta realizuar. Arsytet e emigrimit lidhen me punësimin, arsimin dhe sigurinë për të ardhmen.

Çështjet të cilat shqetësojnë të rinjtë shqiptarë kur mendojnë për të ardhmen janë papunësia, varfëria, rritja e çmimeve, korrupsioni, dhuna dhe krimi, dhuna në familje, shtimi i sëmundjeve etj. Shqetësimet më të mëdha të të rinjve janë më shumë në lidhje me aspekte individuale të jetesës ose të shoqërisë shqiptare (si varfëria, papunësia etj). Ata nuk shfaqen të informuar ose të shqetësuar për fenomene që ndodhin jashtë kontekstit shqiptar, si luftrat brenda dhe jashtë kufijve të Evropës, shfaqja e partive ekstreme të krahut të majtë ose të djathtë etj.

# 6. REKOMANDIMET

# Për politikëbërësit




## Pushteti Qëndror

- Politikat aktive të punësimit duhet të targetojnë punësimin e të rinjve, nëpërmjet nxitjes së punësimit, orientimit të të rinjve drejt sipërmarrjes dhe/ose programeve promovuese për arsimin profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës;
- Krijimi i lehtësirave fiskale për të nxitur sipërmarrjen e të rinjve dhe mbështetjen e programeve ekzistuese start – up, duke mundësuar zbatimin e ideve innovative tek të rinjtë;
- Të hartohen strategji për promovimin dhe rritjen e efektivitetit të arsimit dhe formimit profesional;
- Të rikonceptohen/rivlerësohen programet e nxitjes së punësimit të të rinjve nëpërmjet një qasje gjithpërfshirëse si një mënyrë e parandalimit të emigracionit të paligjshëm.
- Të zhvillohen politika për bashkëjetesën e harmonizuar të familjeve shumë – brezore si dhe politika që promovojnë pavarësinë e të rinjve dhe jetesën autonome;
- Të zhvillohen dhe promovohen politika për shëndetin mendor tek të rinjtë, në mënyrë që të parandalohet shfaqja e çrregullimeve të shëndetit mendor, por edhe të trajtohen rastet që kanë nevojë;
- Hartimi i programeve specifike që nxisin pjesëmarrjen sociale të të rinjve në jetën sociale dhe kulturore;
- Rritja e buxhetit për arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë për të rritur cilësinë e arsimit në të gjitha nivelet, por edhe të shërbimeve që ofrohen në kuadër të arsimit, të tilla si: shërbimi psiko-social, infrastruktura për aktivitete sociale dhe rekreative;
- Aplikimi i bursave për të rinjtë në nevojë për të mbështetur arsimimin e tyre në të gjitha nivelet dhe cilësinë e jetës në të gjitha dimensionet e saj;
- Rritja e masës së ndihmës ekonomike për familjet e varfëra, për të mbështetur arsimimin e fëmijëve të tyre në të gjitha nivelet, duke mos përjashtuar arsimin e mesëm dhe të lartë;



## **Pushteti Vendor**

- Krijimi i hapësirave argëtuese dhe rekreative për të rinjtë në mënyrë që të parandalohen sjelljet delinkuente, por edhe për zhvillimin e tyre më të mirë;
- Të hartohen plane vendore të dedikuara për rininë me pjesëmarrjen direkte të të rinjve në proceset planifikuese dhe vendimmarrëse;
- Krijimi dhe miratimi i buxheteve të dedikuara për të rinjtë në nivel qendror dhe lokal me fokus të veçantë krijimin e hapësirave rekreative të kalimit të kohës së lirë tek të rinjtë;
- Krijimi i sektorëve për rininë në të gjitha bashkitë e vendit për identifikimin dhe adresimin e nevojave të të rinjve;
- Përfshirja e të rinjve në planifikimin e programeve dhe buxhetimit në nivel vendor;
- Promovimi i arsimit profesional dhe i kurseve të formimit profesional, si një mundësi e mirë veçanërisht për të rinjtë që e kanë të vështirë të ndjekin arsimin e lartë në nivel vendor;
- Prioritizimi i investimeve në infrastrukturën e shkollave të mesme dhe profesionale;
- Rritja dhe shpërndarja e shërbimeve psiko-sociale me bazë komunitetin, në të gjithë territorin me qëllim lehtësimin e aksesit në to dhe përmirësimin e mirëqenies psikologjike dhe sociale të të rinjve;
- Krijimi i programeve edukuese/ndërgjegjësuese me bazë komunitare për stilin e jetës së shëndetshme, duke promovuar aktivitetet fizike, social – kulturore etj. si një mënyrë për të reduktuar kohën e shpenzuar në ekran/online.



### **Rekomandime për institucionet përgjegjëse për të rinjtë**

- Përshtatja e kurrikulave dhe të arsimit parauniversitar dhe të lartë me kërkesat e tregut dhe reflektimi i tyre në strategjitë e zhvillimit të IAL-ve dhe të institucioneve përgjegjëse për arsimin profesional;
- Shkollat arsimit të mesëm duhet të fuqizojnë programet e këshillimit të karrierës duke përfshirë aktivitetet përgjatë gjithë vitit që kanë në fokus identifikimin e aftësive të nxënësve dhe informimin e tyre mbi mundësitë;
- Universitetet duhet të marrin masa për krijimin dhe fuqizimin e mëtejshëm të zyrave të karrierës nëpërmjet një qasje gjithpërfshirëse bazuar në nevojat e studentëve.
- Fuqizimi i shërbimit psikosocial në shkolla nëpërmjet rritjes së numrit dhe kapaciteteve të punonjësve të këtij shërbimi në bazë të nevojave moshore dhe metodave specifike për secilën grupmoshë, bazuar në ligjin e arsimit parauniversitar (plotësimi i shërbimit me punonjës socialë dhe psikologë dhe profilizimi i tyre për nevojat specifike të të rinjve);
- Nxitja e institucioneve për përfshirjen më të madhe dhe proaktive të të rinjve në politikat dhe vendimmarrjen e tyre;

## 7. REFERENCAT

- Barrett, P., Treves, A., Shmis, T., Ambasz, D., dhe Ustinova, M. (2018). The impact of school infrastructure for learning: a synthesis of evidence. World Bank Group
- Çela, A. dhe Kamberi, G. (2018). Rinia shqiptare 2018/19. FES Tirana. E marrë nga <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf> e aksesuar në Mars 2019.
- Dumani, B., Bici, R., Dumani, N., Subashi, B. dhe Kondi, A. (2018). Dissemination of Demographic and Socio-Economic Developments in Tirana with Special Attention to Youth Education. Journal of Educational and Social Research, 8 (2)
- EUROSTAT (2009), Youth in Europe, A Statistical Portrait, Publications Office of the European Union, Luxembourg
- EUROSTAT (2015). Being young in Europe today. Marrë nga <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3217494/6776245/KS-05-14-031-EN-N.pdf/18bee6f0-c181-457d-ba82-d77b314456b9> e aksesuar në Mars 2019
- EUROSTAT (2018). Young people living with their parents. E marrë nga <https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-eurostat-news/-/DDN-20181214-1> e aksesuar në Mars 2019
- Evans, M. (2016). Examining the relationship between socioeconomic status and mental health quality of life in a rural neighborhood context. Thesis. University of Iowa. Marrë nga <https://ir.uiowa.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=6425&context=etd> e aksesuar në Mars 2019
- Gallup's Migration Research Center (2018). Measuring our world in motion. Marrë nga <https://news.gallup.com/poll/245225/gallup-migration-research-center.aspx> e aksesuar në Prill 2019;
- Gëdeshi, I. dhe King., R. (2018). Tendencat e migrimit potencial nga Shqipëria. FES, Tirana. Marrë nga <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15271.pdf> e aksesuar në Mars 2019
- Hazizaj, A. dhe Pulaha, K. (2018). Raporti dhe indeksi i vlerësimit për vitet 2015 – 2017 i zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë në Shqipëri 2015 – 2020. CRCA, ANYN. Marrë nga [https://www.crca.al/sites/default/files/publications/RAPORTI%20TE%20RINJTE%20NE%20SHQIPERI%202015-2017\\_1.pdf](https://www.crca.al/sites/default/files/publications/RAPORTI%20TE%20RINJTE%20NE%20SHQIPERI%202015-2017_1.pdf) e aksesuar në Mars 2019
- INSTAT (2015). Të rinjtë në Shqipëri. Marrë nga <http://www.instat.gov.al/media/2791/libri-t%C3%AB-rinjt%C3%AB-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-sfidat-n%C3%AB-koh%C3%ABt-q%C3%AB-ndryshojn%C3%AB.pdf> e aksesuar në Mars 2019
- INSTAT (2017). Anketa e buxhetit të familjes. Marrë nga <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes/publikimet/2018/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes-2017/> e aksesuar në Mars 2019
- INSTAT (2018), Popullsia 1 Janar 2018
- INSTAT (2019). Të dhëna mbi punësimin dhe papunësinë 2015 – 2018. Marrë nga <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pun%C3%ABsimi-dhe->

papun%C3%ABsia/#tab2 e aksesuar në Mars 2019

- INSTAT (2019). Të dhëna për arsimin. E marrë nga <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/#tab2> e aksesuar në 16 Mars 2019
- INSTAT 2018- Anketa Tremujore e Forcave të Punës –T4\_2018, (<http://www.instat.gov.al/media/5305/atfp-t4-2018.pdf>)
- IOM (2011), Glossary on Migration, 2nd Edition
- IDM/Pasos (2015), “Sondazhi i opinionit publik - Besimi në qeveri”
- Ish – Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (2014). Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi dhe plani 2014 – 2020
- MASR (2018). Projektligji për rininë. Marrë nga <http://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/De-taje/109> e aksesuar në Shkurt 2019
- Muenning, P., Jiao, B dhe Singer, E. (2018). Living with parents or grandparents increases social capital and survival: 2014 General Social Survey-National Death Index. SSM Population Health. 4: 71–75
- Youth Bank Hub (2017). Pjesëmarrja Politike, Sociale dhe Ekonomike e të Rinjve në Shqipëri. Raport vjetor. Marrë nga [https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2017/06/raporti\\_vjetor\\_YBH-shqip.pdf](https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2017/06/raporti_vjetor_YBH-shqip.pdf) e aksesuar në Prill 2019.
- Official Journal of the European Union (2018). Resolution of the Council of the European Union and the Representatives of the Governments of the Member States meeting within the Council on a framework for European cooperation in the youth field. The European Union Youth Strategy 2019-2027. Marrë nga <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=OJ:C:2018:456:FULL> e aksesuar në Mars 2019.
- Peci, D. dhe Nikolli, Xh. (2019). Vështrim mbi politikat rinore në Shqipëri: analizë në nivel vendor 2015 – 2019. Marrë nga <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/14341.pdf> e aksesuar në Shkurt 2019
- Perovic, B. (2017). Defining youth in contemporary national legal and policy frameworks across Europe. Marrë nga <https://pjp-eu.coe.int/documents/1017981/1668203/Analytical+paper+Youth+Age+Bojana+Perovic+4.4.16.pdf/eb59c5e2-45d8-4e70-b672-f8de0a5ca08c> e aksesuar në Mars 2019
- Shërbimi Kombëtar i Punësimit (2016). Buketini statistikor 2016. E marrë nga <http://shkp.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/BULETINI-2016.pdf> e aksesuar në Mars 2019
- UN (2018). United Nations Youth Strategy. Marrë nga [https://www.un.org/youthenvoy/wp-content/uploads/2018/09/18-00080\\_UN-Youth-Strategy\\_Web.pdf](https://www.un.org/youthenvoy/wp-content/uploads/2018/09/18-00080_UN-Youth-Strategy_Web.pdf) e aksesuar në Mars 2019.
- UN (2018). Voluntary National Review of Sustainable Development Goals: Albania. Marrë nga [https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/20257ALBANIA\\_VNR\\_2018\\_FINAL2.pdf](https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/20257ALBANIA_VNR_2018_FINAL2.pdf) e aksesuar në Mars 2019
- UNESCO (2014). UNESCO operational strategy on youth 2014-2021 E marrë nga [63](https://unes-</a></li></ul></div><div data-bbox=)

[doc.unesco.org/ark:/48223/pf0000227150](http://doc.unesco.org/ark:/48223/pf0000227150), e aksesuar në Mars 2019

- UNESCO Institute for Statistics. Të dhëna për arsimit. Marrë nga [http://data.uis.unesco.org/Index.aspx?datasetCode=EDULIT\\_DS](http://data.uis.unesco.org/Index.aspx?datasetCode=EDULIT_DS) e aksesuar në Mars 2019
- WHO (2018). Adolescent mental health facts. Marrë nga <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/adolescent-mental-health> e aksesuar në Mars 2019
- Willging, C.E., Quintero, G. dhe Lilliot, E. (2014). Hitting the Wall: Youth Perspectives on Boredom, Trouble, and Drug Use Dynamics in Rural Neë Mexico. *Youth and Society*, 46 (1): 3 – 29
- Witt, P. dhe Caldwell, L. (2010). The Rationale for Recreation Services for Youth: An Evidenced Based Approach. <https://www.nrpa.org/globalassets/research/witt-caldwell-full-research-paper.pdf>. National Recreation and Park Association

## 8. SHTOJCAT

### Shtojca 1. Koeficienti i variacionit



## Univariate Statistics

		Estimate	Standard Error	95% Confidence Interval		Coefficient of Variation
				Lower	Upper	
Mean	2.6 Në përgjithësi, sa të kënaqur jeni me gjendjen financiare individuale?	5.6	0.1	5.4	5.8	1.5%
	3.1 Në përgjithësi, sa të kënaqur jeni ndjerë nga jeta juaj gjatë muajit të fundit?	7.0	0.0	6.9	7.1	0.5%
	2.1 Sa të kënaqur jeni me kushtet e banesës tuaj në një shkallë nga 1 në 10?	7.7	0.1	7.6	7.9	0.8%
	2.2 Sa të kënaqur jeni me hapësirën e banesës në të cilën jetoni?	7.7	0.1	7.5	7.9	0.9%
	2.3 Sa të kënaqur jeni me lagjen/komunitetin në të cilin jetoni?	6.8	0.1	6.6	6.9	0.8%
	2.4 Sa të kënaqur jeni me zonat rekreative/argëtuese në lagjen/komunitetin tuaj?	4.4	0.1	4.1	4.6	1.9%
	5.1 Sa të kënaqur ishit/jeni me infrastrukturën në shkollën/universitetin që ndiqni/ndjekur, në një shkallë nga 1 në 10: [Mjediset fizike]	5.9	0.1	5.6	6.2	1.8%
	5.1 Sa të kënaqur ishit/jeni me infrastrukturën në shkollën/universitetin që ndiqni/ndjekur, në një shkallë nga 1 në 10: [Ambjentet sportive]	5.0	0.2	4.6	5.5	3.3%
	5.1 Sa të kënaqur ishit/jeni me infrastrukturën në shkollën/universitetin që ndiqni/ndjekur, në një shkallë nga 1 në 10: [Laboratorët]	4.9	0.1	4.7	5.1	1.6%
	5.1 Sa të kënaqur ishit/jeni me infrastrukturën në shkollën/universitetin që ndiqni/ndjekur, në një shkallë nga 1 në 10: [Biblioteka]	5.6	0.0	5.5	5.7	0.8%
	5.1 Sa të kënaqur ishit/jeni me infrastrukturën në shkollën/universitetin që ndiqni/ndjekur, në një shkallë nga 1 në 10: [Kushtet (ngrohje/ftohje)]	5.2	0.0	5.0	5.3	0.8%
	5.2 Sa të kënaqur ishit/jeni nga cilësia e mësimdhënies në shkollën/universitetin tuaj?	7.2	0.1	7.0	7.4	0.9%
	7.2 Në një shkallë nga 1 në 10 sa besim keni tek institucionet e mëposhtme: [Policia]	5.2	0.1	5.0	5.4	1.5%
	7.2 Në një shkallë nga 1 në 10 sa besim keni tek institucionet e mëposhtme: [Institucionet shëndetësore publike]	4.9	0.1	4.7	5.1	1.3%
	Në një shkallë nga 1 në 10 sa besim keni tek institucionet e mëposhtme [Spitalet]	5.0	0.1	4.9	5.2	1.2%
	7.2 Në një shkallë nga 1 në 10 sa besim keni tek institucionet e mëposhtme: [Shërbime sociale publike]	4.7	0.1	4.5	4.9	1.5%
	7.2 Në një shkallë nga 1 në 10 sa besim keni tek institucionet e mëposhtme: [Shërbime sociale OJF/private]	4.8	0.1	4.5	5.0	1.7%
	7.2 Në një shkallë nga 1 në 10 sa besim keni tek institucionet e mëposhtme: [Institucionet arsimore publike]	5.4	0.1	5.2	5.6	1.5%
	7.2 Në një shkallë nga 1 në 10 sa besim keni tek institucionet e mëposhtme: [Institucionet e drejtësisë]	4.4	0.1	4.1	4.8	2.9%
	7.2 Në një shkallë nga 1 në 10 sa besim keni tek institucionet e mëposhtme: [Bashkia]	4.6	0.1	4.3	4.8	1.9%
	7.2 Në një shkallë nga 1 në 10 sa besim keni tek institucionet e mëposhtme: [Njësitë Administrative]	4.5	0.1	4.2	4.7	1.9%
	7.2 Në një shkallë nga 1 në 10 sa besim keni tek institucionet e mëposhtme: [Avokati i popullit]	4.2	0.1	3.9	4.5	2.4%
	7.2 Në një shkallë nga 1 në 10 sa besim keni tek institucionet e mëposhtme: [Institucionet e Besimit (xhamia/kisha)]	6.0	0.1	5.8	6.3	1.4%
	7.2 Në një shkallë nga 1 në 10 sa besim keni tek institucionet e mëposhtme: [Media]	4.6	0.1	4.3	4.9	2.1%
	7.2 Në një shkallë nga 1 në 10 sa besim keni tek institucionet e mëposhtme: [Institucionet ndërkombëtare]	5.4	0.1	5.1	5.7	1.9%
	7.2 Në një shkallë nga 1 në 10 sa besim keni tek institucionet e mëposhtme: [Institucionet shëndetësore private]	5.7	0.1	5.4	6.0	1.8%
	7.2 Në një shkallë nga 1 në 10 sa besim keni tek institucionet e mëposhtme: [Institucionet arsimore private]	5.2	0.1	4.9	5.5	2.0%

# INSTRUMENTI I KËRKIMIT

## SESIONI I: TË DHËNA DEMOGRAFIKE

### I.1. Gjinia:

1. Mashkull
2. Femër

### I.2. Viti i Lindjes \_\_\_\_\_

### I.3. Vendbanimi:

a. Berat	e. Korçë
b. Dibër	ë. Kukës
c. Durrës	f. Lezhë
ç. Elbasan	g. Shkodër
d. Fier	gj. Tiranë
dh. Gjirokastrë	h. Vlorë

### I.4. Vendbanimi

1. Zonë urbane
2. Zonë rurale

### I.5. Ju jetoni me:

- a. Me familjen
- b. Me shokë dhe shoqe
- c. Vetëm
- ç. Me partnerin/en
- d. Tjetër (Ju lutem specifikoni)

### I.6. Numri i anëtarëve të familjes (pavarësisht se me kë jetoni, familje e origjinës ose e krijuar) \_\_\_\_\_

### I.7. Nëse jetoni me të tjerë (jo me familjen) sa është numri i personave me të cilët banoni? \_\_\_\_\_

### I.8. Cili është niveli juaj më i lartë i shkollimit të përfunduar?

1. Pa arsim
2. Shkollë fillore
3. Shkolla 8/9-vjeçare (arsim i detyrueshëm)
4. Shkollë e ulët teknike (2-3 vjeçare)
5. Gjimnaz/Shkollë e mesme e përgjithshme
6. Shkolla e mesme profesionale (4-5 vjeçare)
7. Kolegj universitar 2 - vjeçar
8. Universitar (Diplomë e nivelit të parë/Bachelor)
9. Universitar me sistemin e vjetër
10. Pasuniversitar/Master/Diplomë e nivelit të dytë
11. Doktoraturë

**1.9. Cila është fusha e studimit të nivelit tuaj më të lartë të përfunduar? (përgjigjen të gjithë ata që kanë deklaruar alternativat 6 deri 11 në P.5)**

1. Arsim
2. Arte dhe shkencë humane
3. Shkencë sociale, gazetari dhe informacion
4. Biznes, administrim dhe ligje
5. Shkencat e natyrës, matematikë dhe statistikë
6. Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (ICTs)
7. Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim
8. Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinar
9. Shëndetësi dhe mirëqenie
10. Shërbime
11. Tjetër, ju lutemi specifikoni \_\_\_\_\_

**1.10. A keni përfunduar kurse të formimit profesional?**

1. Po    2. Jo

**1.11. Statusi Martesor:**

- Beqar/ Beqare
- I/e martuar
- I/e pa martuar ligjrisht, por në një bashkëjetesë
- I/e ndarë, por ligjrisht i/e martuar
- I/e divorcuar
- I/e ve

**1.12. Të ardhurat mesatare mujore të familjes suaj (familjes me të cilën jetoni në një banesë, atë të origjinës ose të krijuar):**

- 0 – 18 000 Lekë
- 18 001 – 35 000 Lekë
- 35 001 – 87 000 Lekë
- Më shumë se 87 000 Lekë
- Nuk e di
- Refuzoj të përgjigjem

**1.13. Punësimi (mund të qarkoni më shumë se një alternativë)**

1. Punë të rregullt kundrejt një page
2. Në biznesin tuaj/familjes apo në profesion të lirë
3. Në fermën tuaj/familjes
4. Ndonjë punë të rastit kundrejt një page/përfitim
5. I/e papunë
6. Student/Nxënës
7. Shtëpiak/e
8. I/e paaftë për punë

**(Në pyetjet në vijim përgjigjen të gjithë ata që kanë deklaruar alternativat I deri 5 në P.13)**

**I.14. Lloji i punës:**

- Punë me kohë të plotë
- Punë me kohë të pjesshme
- Tjetër, ju lutem, specifikoni \_\_\_\_\_

**I.15. Aktiviteti ekonomik në të cilin punoni:**

- Bujqësi
- Ndërmjetësimi financiar
- Industria nxjerrëse
- Arsim
- Administrim publik
- Transport/Telekomunikacion
- Shëndetësi
- Prodhim energjie, gaz, ujë
- Pasuritë e patundshme
- Ndërtim
- Tregëti
- Industria përpunuese
- Hotele/restorante
- Aktivitete të tjera, ju lutem specifikoni \_\_\_\_\_

**I.16. Grup profesionet:**

- Mbrojtja dhe rendi
- Punëtorë të paspecializuar
- Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe paisjeve
- Ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtues, manaxher
- Specialistë/profesionistë (edukimi, shëndetësi, inxhinieri, ekonomi, etj.)
- Teknikë dhe ndihmës specialistë
- Nëpunës
- Punonjës të shitjeve dhe shërbimeve
- Punëtorë të kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit
- Zejtare dhe punëtorë të zanateve të ndryshme
- Tjetër, ju lutem specifikoni \_\_\_\_\_

**1.17. Në përgjithësi, sa të kënaqur jeni me punën?**

(Nga 1 në 10, ku 1 është "aspak i/e kënaqur" dhe 10 është "plotësisht i/e kënaqur").

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10

**1.18. Në përgjithësi, sa të kënaqur jeni me kohën e udhëtimit nga shtëpia në punë?**

(Nga 1 në 10, ku 1 është "aspak i/e kënaqur" dhe 10 është "plotësisht i/e kënaqur").

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10

Shenim: Kënaqësia e ulët i referohet vlerësimit 0-5; Kënaqësia e mesme i referohet vlerësimit 6-8 dhe kënaqësia e lartë për vlerësimin 9-10.

## **SESIONI II: KUSHTET E BANIMIT**

**2.1. Sa të kënaqur jeni me kushtet e banesës suaj në një shkallë nga 1 në 10, ku 1 është "aspak i/e kënaqur" dhe 10 është "plotësisht i/e kënaqur"?**

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10

**2.2. Sa të kënaqur jeni me hapësirën e banesës në të cilën jetoni?**

(Nga 1 në 10, ku 1 është "aspak i/e kënaqur" dhe 10 është "plotësisht i/e kënaqur").

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10

**2.3. Sa të kënaqur jeni me lagjen/komunitetin në të cilin jetoni?**

(Nga 1 në 10, ku 1 është "aspak i/e kënaqur" dhe 10 është "plotësisht i/e kënaqur").

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10

**2.4. Sa të kënaqur jeni me zonat rekreative/argëtuese në lagjen/komunitetin tuaj?**

(Nga 1 në 10, ku 1 është "aspak i/e kënaqur" dhe 10 është "plotësisht i/e kënaqur").

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10

**2.5. Sa të sigurtë (siguri fizike) ndjeheni në lagjen/komunitetin tuaj?**

- 1 shumë i/e pasigurt  
 2 pak i/e pasigurt  
 3 mjaft i/e sigurt  
 4 shumë i/e sigurt  
 5 nuk e di

**2.6. Sa të kënaqur jeni me gjendjen financiare individuale?**

(Nga 1 në 10, ku 1 është "aspak i/e kënaqur" dhe 10 është "plotësisht i/e kënaqur").

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10

**SESIONI III: GJENDJA EMOCIONALE**

**3.1 Në përgjithësi, sa të kënaqur jeni ndjerë nga jeta juaj gjatë muajit të fundit?**

(Nga 1 në 10, ku 1 është "aspak i/e kënaqur" dhe 10 është "plotësisht i/e kënaqur").

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10

**3.2 Sa shpesh jeni ndjerë të lumtur gjatë muajit të fundit?**

- 1 Asnjëherë
- 2 Rrallëherë
- 3 Disa herë
- 4 Shpeshherë
- 5 Gjithmonë
- 6 Nuk e di
- 7 Nuk dëshiroj të përgjigjem

**3.3. Sa shpesh jeni ndjerë shumë nervoz gjatë muajit të fundit? ?**

- 1 Asnjëherë
- 2 Rrallëherë
- 3 Disa herë
- 4 Shpeshherë
- 5 Gjithmonë
- 6 Nuk e di
- 7 Nuk dëshiroj të përgjigjem

**3.4 Sa shpesh jeni ndjerë të rënë moralisht gjatë muajit të fundit? ?**

- 1 Asnjëherë
- 2 Rrallëherë
- 3 Disa herë
- 4 Shpeshherë
- 5 Gjithmonë
- 6 Nuk e di
- 7 Nuk dëshiroj të përgjigjem

**3.5. Sa shpesh jeni ndjerë të qetë gjatë muajit të fundit? ?**

- 1 Asnjëherë
- 2 Rrallëherë
- 3 Disa herë
- 4 Shpeshherë
- 5 Gjithmonë
- 6 Nuk e di
- 7 Nuk dëshiroj të përgjigjem

**3.6 Sa shpesh jeni ndjerë të dëshpëruar gjatë muajit të fundit?**

- 1 Asnjëherë
- 2 Rrallëherë
- 3 Disa herë
- 4 Shpeshherë
- 5 Gjithmonë
- 6 Nuk e di
- 7 Nuk dëshiroj të përgjigjem

**SESIONI IV: MARRËDHËNIET FAMILJARE DHE SHOQËRORE**

**4.1. Si do t'i vlerësonit marrëdhëniet me nënën/mamanë tuaj?**

(në një shkallë nga 1-10 (ku 1- problematike dhe 10- shumë të mira)

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10     Nuk e kam

**4.2. Si do t'i vlerësonit marrëdhëniet me babain tuaj?**

(në një shkallë nga 1-10 (ku 1- problematike dhe 10- shumë të mira)

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10     Nuk e kam

**4.3. Si do t'i vlerësonit marrëdhëniet me motrën/at tuaj/a?**

(në një shkallë nga 1-10 (ku 1- problematike dhe 10- shumë të mira)

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10     Nuk kam motër

**4.4. Si do t'i vlerësonit marrëdhëniet me vëllain/ezërit tuaj?**

(në një shkallë nga 1-10 (ku 1- problematike dhe 10- shumë të mira)

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10     Nuk kam vëlla

**4.5. Sa shpesh takoheni me të afërmit (e brezit të parë)**

- 1 Kurrë  
 2 Të paktën një herë në vit (më pak se një herë në muaj)  
 3 Një herë në muaj  
 4 Disa herë në muaj (jo çdo javë)  
 5 Çdo javë (jo çdo ditë)  
 6 Çdo ditë

**4.6. Sa shpesh takoheni me miqtë (që janë në rrethin tuaj të afërt shoqëror)?**

- 1 Kurrë  
 2 Të paktën një herë në vit (më pak se një herë në muaj)  
 3 Një herë në muaj  
 4 Disa herë në muaj (jo çdo javë)  
 5 Çdo javë (jo çdo ditë)  
 6 Çdo ditë

**SESIONI V: SHKOLLIMI DHE ZGJEDHJA E KARRIERËS**

**5.1 Sa të kënaqur jeni me infrastrukturën në shkollën/universitetin që ndiqni, në një shkallë nga 1 në 10, ku 1 është "aspak i/e kënaqur" dhe 10 është "plotësisht i/e kënaqur").:**

- Mjediset fizike:            1     2     3     4     5     6     7     8     9     10    II. Nuk ka  
 Ambjentet sportive:    1     2     3     4     5     6     7     8     9     10    II. Nuk ka  
 Laboratorët:            1     2     3     4     5     6     7     8     9     10    II. Nuk ka  
 Biblioteka                1     2     3     4     5     6     7     8     9     10    II. Nuk ka  
 Kushtet (ngrohje/ftohje) 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10    II. Nuk ka

**5.2 Sa të kënaqur ishit/jeni nga cilësia e mësimdhënies në shkollën/universitetin tuaj?**

(Nga 1 në 10, ku 1 është "aspak i/e kënaqur" dhe 10 është "plotësisht i/e kënaqur").

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10



**5.3 Si do ta vlerësonit përmbajtjen e teksteve shkollore/akademike, në një shkallë nga 1-10, ku 1 është "aspak i/e kënaqur" dhe 10 është "plotësisht i/e kënaqur".**

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10

**5.4 Sa herë në javë ndiqni kurse që lidhen me formimin tuaj:**

Lloji	1 herë në javë	2 herë në javë	Më shumë se 2 herë në javë	Nuk i frekuentoj
a. Gjuhë të huaja				
b. Kompjuter				
c. Kurse të shkencave ekzakte (matematikë, fizikë etj.)				
ç. Kurse formimi profesional (estetikë, parukeri, hidraulik, mekanik elektroauto etj.)				
d. Kurse të formimit ndër/personal (komunikim, lidhësi, menaxhim projektesh)				
dh. Tjetër (ju lutem, specifikoni)				

**5.5 Me kë jeni konsultuar për të zgjedhur profesionin/karrierën tuaj? (mund të zgjidhet më shumë se një alternativë):**

- me asnjë(vetë)
- prindër
- vëllezër/motra
- shokë/shoqe
- kushërinj/të afërm
- shkolla
- qendra këshillimi të karrierës në shkolla apo fakultet

**5.6 Sa ju kanë ndihmuar strukturat arsimore (shkolla/universiteti) në zgjedhjen e karrierës? (në një shkallë nga 1-10, ku 1 është "aspak" dhe 10 është "shumë")**

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10

**5.7 Sa të kënaqur jeni me zgjedhjen tuaj lidhur me arsimimin?**

(në një shkallë nga 1-10, ku 1 është "aspak i/e kënaqur" dhe 10 është "plotësisht i/e kënaqur")

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10

**5.8 Sa të kënaqur jeni me zgjedhjen tuaj lidhur me karrierën?**

(në një shkallë nga 1-10, ku 1 është "aspak i/e kënaqur" dhe 10 është "plotësisht i/e kënaqur")

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10

### 5.9 A lidhet puna që po bëni aktualisht me fushën në të cilën keni studiuar?

- Po, punoj në fushën në të cilën kam studiuar
- Jo, nuk punoj fushën për të cilën kam studiuar
- Punoj në një fushë të ngjashme me atë për të cilën kam studiuar
- Nuk jam duke punuar

## SESIONI VI: KOHA E LIRË

### 6.1 Në përgjithësi, sa të kënaqur jeni me përdorimin e kohës së lirë?

(Nga 1 në 10, ku 1 është "aspak ile kënaqur" dhe 10 është "plotësisht ile kënaqur").

- 1       2       3       4       5       6       7       8       9       10      I I. Nuk kam kohë të lirë

### 6.2 Sa herë në muaj shkoni në aktivitetet e mëposhtme:

Lloji	1 herë në javë	2 herë në javë	Më shumë se dy herë në javë	Nuk i frekuentoj
a. Kinema				
b. Teatër				
c. Ekspozitë				
ç. Muze				
d. Lexim librash				

### 6.3 Sa herë në javë ndiqni kurse/aktivitete sportive:

Lloji	1 herë në javë	2 herë në javë	Më shumë se dy herë në javë	Nuk i frekuentoj
a. Futboll				
b. Basketboll				
c. Volejbol				
ç. Not				
d. Palestër				

### 6.4 Sa herë në javë ndiqni kurse arti, kulture:

Lloji	1 herë në javë	2 herë në javë	Më shumë se dy herë në javë	Nuk i frekuentoj
a. Pikturë				
b. Instrument muzikor				
c. Balet/kërcim				
ç. Fotografi				

### 6.5 Sa herë merrni pjesë në aktivitete vullnetare?

- 1 Kurrë  
 2 Të paktën një herë në vit (më pak se një herë në muaj)  
 3 Një herë në muaj  
 4 Disa herë në muaj (jo çdo javë)  
 5 Çdo javë (jo çdo ditë)  
 6 Çdo ditë

### 6.6 Pjesëmarrja në aktivitete/organizime:

Lloji	PO	JO
a. Parti politike apo sindikatave		
b. Shoqata profesionale		
c. Aktivitete dhe organizime me bazë fetare		
ç. Aktivitete dhe organizata bamirësie		
d. Aktivitetet e grupeve apo organizatave të shoqërisë civile		

### 6.7 Sa kohë shpenzoni në aktivitetet e mëposhtme:

	më pak se 2 orë në ditë	2-3 orë në ditë	3-4 orë në ditë	4-5 orë në ditë	Më shumë se 5 orë	Nuk shpenzoj kohë në këtë aktivitet
a. Televizor						
b. Facebook						
c. Instagram						
ç. Twitter						
d. You tube						
e. LinkedIn						
ë. Snapchat						
f. Internet (përveç mediave sociale dhe alternativave të tjera të paraqitura më poshtë)						

## SESIONI VII: AKSESI NË SHËRBIME DHE BESIMI TEK INSTITUCIONET

### 7.1 Në një situatë shqetësuese për ju, kujt i drejtoheni për ndihmë (më shumë se një alternativë)

- Familjarëve (mama, baba, vëlla, motër, hallë, gjysh/e, teze, dajë.)
- Partneri/ja
- Miqve (përfshirë miqtë e Facebook dhe mediat e tjera sociale)
- Mbështetje në universitet (p.sh lektorëve, bashkëmoshatarëve)
- Mbështetja jashtë universitetit nga një punonjës shëndetësor ose social (p.sh. mjeku, infermierja, P.soc.)
- Punës (p.sh. kolegët, mbështetja në vendin e punës)
- Institucioneve të besimit (xhamia, kisha ose grup tjetër i bazuar në besim)
- Shokëve/shoqeve të kurseve të ndryshme që mund të frekuentoni (sportive, kulturore, artistike)
- Ndhimave telefonike (ku mund të flasësh për situatën shqetësuese me një profesionist)
- Burimeve në internet (faqet e internetit)
- Tjetër (ju lutem na tregoni tek kush tjetër drejtoheni për ndihmë) \_\_\_\_\_

### 7.2 Në një shkallë nga 1 në 10 sa besim keni tek institucionet e mëposhtme: (ku 1 është “aspak besim” dhe 10 është “shumë besim”)

Policia	1	<input type="radio"/> 2	<input type="radio"/> 3	<input type="radio"/> 4	<input type="radio"/> 5	<input type="radio"/> 6	<input type="radio"/> 7	<input type="radio"/> 8	<input type="radio"/> 9	<input type="radio"/> 10
Inst. shëndetësore publike	1	<input type="radio"/> 2	<input type="radio"/> 3	<input type="radio"/> 4	<input type="radio"/> 5	<input type="radio"/> 6	<input type="radio"/> 7	<input type="radio"/> 8	<input type="radio"/> 9	<input type="radio"/> 10
Inst.shëndetësore private	1	<input type="radio"/> 2	<input type="radio"/> 3	<input type="radio"/> 4	<input type="radio"/> 5	<input type="radio"/> 6	<input type="radio"/> 7	<input type="radio"/> 8	<input type="radio"/> 9	<input type="radio"/> 10
Spitalet	1	<input type="radio"/> 2	<input type="radio"/> 3	<input type="radio"/> 4	<input type="radio"/> 5	<input type="radio"/> 6	<input type="radio"/> 7	<input type="radio"/> 8	<input type="radio"/> 9	<input type="radio"/> 10
Shërbimet sociale publike	1	<input type="radio"/> 2	<input type="radio"/> 3	<input type="radio"/> 4	<input type="radio"/> 5	<input type="radio"/> 6	<input type="radio"/> 7	<input type="radio"/> 8	<input type="radio"/> 9	<input type="radio"/> 10
Shërbimet sociale OJF/private	1	<input type="radio"/> 2	<input type="radio"/> 3	<input type="radio"/> 4	<input type="radio"/> 5	<input type="radio"/> 6	<input type="radio"/> 7	<input type="radio"/> 8	<input type="radio"/> 9	<input type="radio"/> 10
Institucionet arsimore publike	1	<input type="radio"/> 2	<input type="radio"/> 3	<input type="radio"/> 4	<input type="radio"/> 5	<input type="radio"/> 6	<input type="radio"/> 7	<input type="radio"/> 8	<input type="radio"/> 9	<input type="radio"/> 10
Institucionet arsimore private	1	<input type="radio"/> 2	<input type="radio"/> 3	<input type="radio"/> 4	<input type="radio"/> 5	<input type="radio"/> 6	<input type="radio"/> 7	<input type="radio"/> 8	<input type="radio"/> 9	<input type="radio"/> 10
Institucionet e drejtësisë	1	<input type="radio"/> 2	<input type="radio"/> 3	<input type="radio"/> 4	<input type="radio"/> 5	<input type="radio"/> 6	<input type="radio"/> 7	<input type="radio"/> 8	<input type="radio"/> 9	<input type="radio"/> 10
Bashkia	1	<input type="radio"/> 2	<input type="radio"/> 3	<input type="radio"/> 4	<input type="radio"/> 5	<input type="radio"/> 6	<input type="radio"/> 7	<input type="radio"/> 8	<input type="radio"/> 9	<input type="radio"/> 10
Njësitë Administrative	1	<input type="radio"/> 2	<input type="radio"/> 3	<input type="radio"/> 4	<input type="radio"/> 5	<input type="radio"/> 6	<input type="radio"/> 7	<input type="radio"/> 8	<input type="radio"/> 9	<input type="radio"/> 10
Avokati i popullit	1	<input type="radio"/> 2	<input type="radio"/> 3	<input type="radio"/> 4	<input type="radio"/> 5	<input type="radio"/> 6	<input type="radio"/> 7	<input type="radio"/> 8	<input type="radio"/> 9	<input type="radio"/> 10
Institucione të besimit(xhamia/kisha)	1	<input type="radio"/> 2	<input type="radio"/> 3	<input type="radio"/> 4	<input type="radio"/> 5	<input type="radio"/> 6	<input type="radio"/> 7	<input type="radio"/> 8	<input type="radio"/> 9	<input type="radio"/> 10
Media	1	<input type="radio"/> 2	<input type="radio"/> 3	<input type="radio"/> 4	<input type="radio"/> 5	<input type="radio"/> 6	<input type="radio"/> 7	<input type="radio"/> 8	<input type="radio"/> 9	<input type="radio"/> 10
Institucionet ndërkombëtare	1	<input type="radio"/> 2	<input type="radio"/> 3	<input type="radio"/> 4	<input type="radio"/> 5	<input type="radio"/> 6	<input type="radio"/> 7	<input type="radio"/> 8	<input type="radio"/> 9	<input type="radio"/> 10

## **SESIONI VIII: EMIGRIMI**

### **8.1 A keni emigruar ndonjëherë nga Shqipëria?**

- Po  
 Jo

### **8.2 A keni menduar ndonjëherë të largoheni nga Shqipëria?**

- Po, e kam menduar, por nuk kam ndërmarrë hapa konkretë  
 E kam menduar dhe kam ndërmarrë hapa konkretë  
 Kam tentuar disa herë  
 Jo, nuk e kam menduar

### **8.3 Nëse po, cilat janë arsyet e largimit nga Shqipëria?**

- Arsimimi  
 Punësimi  
 Shëndeti  
 Bashkim familjar  
 Siguria  
 Tjetër, ju lutem specifikoni \_\_\_\_\_

## **SESIONI IX : VLERAT DHE E ARDHMJA**

### **9.1 Në përgjithësi, në çfarë mase mendoni se gjërat që bëni në jetën tuaj janë të vlefshme për ju? (Ku 1 është "aspak i vlefshëm" dhe 10 është "krejtësisht i vlefshëm".)**

- 1     2     3     4     5     6     7     8     9     10

## 9.2 Cilat nga gjërat e mëposhtme janë më të rëndësishme për ju?

	Shumë e rëndësishme	E rëndësishme	Disi e rëndësishme	Pak e rëndësishme	Aspak e rëndësishme
Të jem i/e shëndetshëm/e					
Të jem i/e punësuar					
Të bëj karrierë					
Të kem një arsim të mirë					
Të kem një marrëdhënie të lumtur					
Të kem fëmijë					
Të kombinoj jetën profesionale me jetën familjare					
Të kem një shtëpi të bukur					
Të qëndroj/jetoj në vendin tim					
Të udhëtoj në vende të tjera					
Të jetoj aty ku dëshiroj					
Të ndjehem i/e sigurt në vendin tim					
Të ndjehem i/e vlerësuar në vendin tim					
Të jetoj në një mjedis të shëndetshëm					
Të jetoj në një mjedis natyror më miqësor					
Të kem një makinë të mirë					
Të kem shumë para					
Të kem një jetë të mirë sociale					
Të jem i/e lumtur					

**9.3 Kur mendoni për të ardhmen tuaj për cilat nga gjërat e mëposhtme jeni të shqetësuar?**

	Kjo më shqetëson mua...					
	Jashtëzakonisht shumë	Shumë	Disi	Shumë pak	Aspak	Nuk kam informacion
Rritja e çmimeve						
Varfëria						
Papunësia						
Vendet fqinje që janë duke falimentuar						
Terrorizmi						
Dhuna dhe krimi						
Dhuna në familje						
Lufta jashtë Evropës						
Lufta në Evropë						
Kufizimet dhe dhuna në kufijtë e Evropës						
Feja dhe/ose konfliktet etnike						
Trazirat sociale						
Paragjykimi, diskriminimi dhe racizmi						
Mungesa e meritokracisë/Nepotizmi						
Mungesa e barazisë gjinore						
Mungesa e transparencës						
Hendeku ndërmjet të pasurve dhe të varfëve						
Lindja e partive ekstreme të krahut të djathtë						
Lindja e partive ekstreme të krahut të majtë						
Epidemitë e sëmundjeve të papritura						
Shtimi i sëmundjeve						
Fluksi i emigrantëve dhe refugjatëve						
Fatkeqësi mjedisore ose natyrore						
Mundësia/dukuria e përgjimit nga shteti						
Militarizimi në kufijtë e Evropës						
Shpërbërja e Bashkimit Evropian						
Çensura/kontrolli i informacionit						
Nacionalizmi në Evropë						
Më pak solidaritet në Evropë						

Mungesa e shërbimeve sociale në Shqipëri							
Ndryshimi i klimës							
Korrupsioni							
Presioni politik							
Diktatura							

**Faleminderit për kontributin tuaj!**





TË RINJTË NË  
SHQIPËRI

20  
19



RAPORT  
STUDIMOR  
**TË RINJTË  
NË SHQIPËRI**